



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 748 Akti

Nr. 746 Vendimi
Tiranë, më 20.3.2024

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Xhensila Pine	Kryesuese
Roland Ilia	Relator
Genta Tafa (Bungo)	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Amela Idrizi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, në Tiranë, në datën 20.3.2024, ora 10:00 në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), kati 0, salla B, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Gerti Shani**, me detyrë ndihmës ligjor pranë ish-Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, aktualisht këshilltar ligjor pranë Gjykatës së Lartë, i cili kërkoi konfirmimin në detyrë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/ b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisionerin Roland Ilia, subjektin e rivlerësimit Gerti Shani, vëzhguesin ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, si dhe pasi shqyrtoi në seancë dëgjimore publike në tërësinë e tij vlerësimin kalimtar ndaj subjektit, i cili kërkoi konfirmimin e tij në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Gerti Shani, aktualisht me detyrën e këshilltarit ligjor pranë Gjykatës së Lartë, është subjekt i rivlerësimit që i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 4 të nenit 179/b të Kushtetutës së Shqipërisë, pasi në kohën e dorëzimit të deklaratës *Vetting* ushtronte detyrën e ndihmësit ligjor që nga data 18.6.2015 pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

2. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni ka hedhur shortin në datën 15.6.2021, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit Gerti Shani do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues, i përbërë nga komisionerët Genta Tafa (Bungo), Roland Ilia dhe Xhensila Pine. Me vendimin datë 18.6.2021, u vendos zgjedhja e komisionerit Roland Ilia si relator i çështjes; kryesuese e trupit gjykues u caktua me mirëkuptim komisionere Xhensila Pine; vëzhgues ndërkombëtar z. Francesco Ciardi. Gjithashtu, nga anëtarët e trupit gjykues u deklarua se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Gerti Shani.

3. Subjektit të rivlerësimit iu komunikua me *email* datë 18.3.2023 përbërja e trupit gjykues dhe iu bë me dije e drejta për t’u shprehur mbi konfliktin e interesit. Subjekti i rivlerësimit sipas kërkesës së Komisionit ka deklaruar mungesën e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.

4. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim, Komisioni) janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ).

5. Në vijim, nga ana e relatorit të çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit është zhvilluar mbi një hetim administrativ të thelluar me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për të tria kriteret e vlerësimit.

6. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, në datën 4.3.2024 vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit Gerti Shani; (ii) njoftimin e subjektit për t’u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera me qëllim për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

7. Subjekti i rivlerësimit u njoftua në datën 4.3.2024 mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/sqarime shtesë apo për të kërkuar marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni.

8. Subjekti i rivlerësimit, pasi u njoh me rezultatet e hetimit, ka dërguar prapësimet pranë Komisionit nëpërmjet postës zyrtare në datën 12.3.2024, në lidhje me rezultatet e hetimit të dërguara nga Komisioni.

9. Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim dhe analizoi shpjegimet e paraqitura dhe provat në lidhje me rezultatet e hetimit, vendosi të ftojë z. Gerti Shani në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

II. SEANCA DËGJIMORE

10. Subjekti i rivlerësimit Gerti Shani u ftua në seancën dëgjimore nëpërmjet njoftimit elektronik me *email-in* e datës 18.3.2024.

11. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 20.3.2024 (ora 10:00) në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati 0, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi.

12. Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht dhe i përfaqësuar nga avokati mbrojtës, z. E.K, me nr. licence ***, si dhe mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur e parashtruar shpjegimet dhe opinionet e tij në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit Gerti Shani kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

13. Z. Gerti Shani ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, duke u përgjigjur kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 dhe duke respektuar afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

14. Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

15. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

16. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

17. Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, AKSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

18. Sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016 parashikohet objekti i rivlerësimit të aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

19. Referuar vendimit nr. 2/20171 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e këtij funksioni kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli e rivlerësimi që nuk bazohet dhe as detyrohet nga përfundimet e paraqitura prej organeve të tjera ndihmëse.

20. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* dhe deklaratat periodike vjetore të dorëzuara ndër vite nga subjekti në ILDKPKI;
- ç) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- d) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga AKSIK-ja;
- dh) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGJ-ja;
- e) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A.1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

21. Bazuar në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja përfundoi kontrollin e plotë të deklaratës së pasurisë dhe në përputhje me pikën 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016 konstatohet se për subjektin e rivlerësimit Gerti Shani ka konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

22. Në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, dhe ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, subjekti ka dorëzuar vetëm deklaratën *Vetting*, meqë edhe periudha në detyrë e tij shtrihet në periudhën 18.6.2015 – 26.1.2017.

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

23. Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni nisi shqyrtimin e deklaratimeve të interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë në ILDKPKI, duke i krahasuar me dokumentet e tjera të administruara gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron kryerjen e procesit të vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit Gerti Shani, pas:

- a) shqyrtimit të të dhënave të deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, me nr. indeksi ***, datë 26.1.2017, për subjektin e rivlerësimit;
- b) shqyrtimit të të dhënave nga të gjitha bankat e nivelit të dytë, institucionet financiare dhe jofinanciare, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, organet tatimore, organet e tjera shtetërore, personat juridikë, individët, si dhe likuiditeteve – gjendje *cash*;
- c) hetimit të kryer lidhur me të dhënat e vetëdeklaruara nga subjekti gjatë plotësimit të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni.

24. Në deklaratën e pasurisë *Vetting*, të dorëzuar në ILDKPKI, subjekti i rivlerësimit Gerti Shani ka deklaruar pasuritë si vijojnë:

Deklarimet nga subjekti i rivlerësimit Gerti Shani¹ për pasuritë e krijuara para detyrës:

1. Apartament me sip. 81 m², me vendndodhje në Rrugën e *, Tiranë,** pranë ***, godina ***, apartamenti ***, shkalla nr. ***, kati ***, z. k. ***, me të ardhura të siguruara nga biznesi familjar ndër vite (bashkëlidhur kontrata e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.6.2003, e redaktuar nga notere publike M. Sh.). Vlera totale e kontratës: 2,000,000 lekë. Pjesa takuese: 100%.

1.1 Subjekti i rivlerësimit i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.6.2003, ku pronari Sh.Sh shet blerësit Gerti Shani apartamentin ***, me sip. 81 m², shkalla ***, godina ***, kati ***, i regjistruar në regjistrin hipotekor nr. ***, z. k. ***, Tiranë, kundrejt çmimit 2,000,000 lekë, i likuiduar jashtë zyrës noteriale.

1.2 ASHK Drejtoria Vendore Tirana Veri ka konfirmuar dhe dërguar dokumentacionin provues² se në pronësi të shtetasit Gerti Shani është regjistruar apartamenti me sip. 81 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, ***, ***, shk. ***, ap. ***, apartamenti të cilin e ka blerë në vlerën 2,000,000 lekë.

1.3 Shpenzimet në shumën rreth 400,000 lekë, që subjekti ka deklaruar³ gjatë hetimit se i ka bërë për mobilimin e apartamentit para fillimit të detyrës dhe për të cilat nuk ka mbajtur fatura meqë në atë kohë nuk ka pasur detyrim për të deklaruar, Komisioni i ka përfshirë në analizën financiare për periudhën 2003 – 2007, duke konsideruar se këto lloj shpenzimesh zakonisht bëhen në vitet e menjëhershme pasardhëse, pas blerjes së një pasurie.

1.4 Për sa më sipër, Komisioni nuk konstatoi problematika në lidhje me këtë pasuri.

¹ Deklarimi i pasurisë sipas deklaratës *Vetting*.

² Shkresa nr. *** prot., datë 22.6.2023 e ASHK Drejtoria Vendore Tirana Veri, drejtuar Komisionit. Bashkëlidhur: kartela e pasurisë së paluajtshme datë 20.6.2023 për apartamentin me sip. 81 m²; vërtetim pronësie datë 3.7.2003, ku apartamenti është regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit; praktika e vitit 2011 për rivlerësimin e këtij apartamenti dhe taksat që ka paguar me këtë rast subjekti i rivlerësimit.

³ Në pyetësorin standard.

2. Apartament në Fier, me vendndodhje në rrugën “**”, Fier,** pasuria nr. ***, vol. ***, f. ***, pallati nr. ***, shkalla ***, kati ***, apartamenti nr. ***, z. k. ***, me të ardhura të siguruara nga biznesi familjar ndër vite (bashkëlidhur këtij deklarami, kartela e pasurisë me datë 24.1.2017 e lëshuar nga ZVRPP-ja Fier). Vlera totale e kontratës: 1,000,000 lekë. Pjesa takuese: 100%.

2.1 Subjekti i rivlerësimit i ka bashkëlidhur deklaratën *Vetting* kartelën e pasurisë së paluajtshme datë 24.1.2017, lëshuar nga ZVRPP-ja Fier, për apartamentin nr. ***, me sip. 54 m², godina ***, shk. ***, kati ***, me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, Fier, shuma e paguar 1,000,000 lekë.

2.2 ZVRPP Fier dhe ASHK Drejtoria Vendore Fier konfirmojnë se shtetasi Gerti Shani ka të regjistruar në pronësi të tij apartamentin me sip. 54 m², nr. pasurie *** e cila ndodhet në vol. ***, f. ***, z. k. ***, me certifikatë të lëshuar në datën 28.9.2004, të cilin e ka blerë sipas kontratës së shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.9.2004, kundrejt çmimit 1,000,000 lekë, që është paguar jashtë zyrës noteriale.

2.3 Shpenzimet në shumën rreth 200,000 lekë, që subjekti ka deklaruar⁴ gjatë hetimit se i ka bërë për mobilimin e apartamentit para fillimit të detyrës dhe për të cilat nuk ka mbajtur fatura meqë në atë kohë nuk ka pasur detyrim për të deklaruar, Komisioni i ka përfshirë në analizën financiare për periudhën 2004 – 2007, duke konsideruar se këto lloj shpenzimesh zakonisht bëhen në vitet e menjëhershme pasardhëse, pas blerjes së një pasurie.

2.4 Për sa më sipër, Komisioni nuk konstatoi problematika në lidhje me këtë pasuri.

3. Llogari në Bankën e Shqipërisë, dega Lushnjë, hapur në datën 17.1.2003 dhe mbyllur në datën 8.6.2010, në vlerë totale 3,300,000 lekë. Të ardhura të siguruara nga biznesi familjar ndër vite (bashkëngjitur nxjerrje llogarie datë 21.10.2016, lëshuar nga Banka e Shqipërisë, dega Lushnjë). Janë përfituar interesa në shumën 1,819,670 lekë dhe janë paguar 181,965 lekë.

3.1 Nga lëvizja e llogarisë së Bankës së Shqipërisë, dega Lushnjë, rezulton se subjekti ka marrë pjesë në ankandin e bonove të thesarit, për herë të parë në datën 21.1.2003, duke investuar shumën 3.3 milionë lekë. Në vijim, kjo shumë është investuar disa vite rresht dhe investimi i fundit është në vlerën 3,000,000 lekë pas pjesëmarrjes në ankandin nr. *** të Bankës së Shqipërisë të datës 3.6.2010. Afati i kësaj bonoje thesari ka qenë 1-vjeçar, me maturim në datën 2.6.2011, ndërsa në deklaratën *Vetting* subjekti i rivlerësimit ka deklaruar afat maturimi datën 8.6.2010.

3.2 Nga ana tjetër, nga verifikimi i lëvizjeve të llogarisë bankare të subjektit në Raiffeisen Bank u evidentua shuma 2,869,098 lekë, e cila ka kaluar në llogarinë e pagës së tij në datën 4.11.2010, me urdhërues Ministria e Financave.

3.3 Për të verifikuar transaksionet dhe deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, Komisioni i kërkoi që të sqarojë se kur është shlyer bonoja e thesarit dhe çfarë përfaqëson shuma 2,869,098 lekë, e transferuar nga Ministria e Financave tek llogaria e tij në Raiffeisen Bank.

3.4 Në përgjigje⁵, subjekti ka shpjeguar se kjo shumë përfaqëson vlerën monetare që ai ka investuar në bono thesari në datën 3.6.2010, të cilat janë shlyer në datën 4.11.2010, pra përpara datës së maturimit të tyre që do të ishte 2.6.2011. Shuma në vlerën 2,869,098 lekë ka kaluar në

⁴ Në pyetësorin standard.

⁵ Përgjigjja nr. ***, pyetësori nr. ***.

Raiffeisen Bank dhe, më pas, është tërhequr prej tij në datën 8.11.2010. Kalimi i shumës është kryer nga Ministria e Financave si përfaqësuese e qeverisë shqiptare, e cila është autoriteti që blen bono thesari nëpërmjet ankandit të zhvilluar nga Banka e Shqipërisë.

3.5 Nga ana e saj, Banka e Shqipërisë konfirmon⁶ se z. Gerti Shani ka investuar pranë kësaj banke vlerën nominale 3 milionë lekë për bono thesari pas pjesëmarrjes në ankandin nr. ***, datë 3.6.2010. Kjo bono thesari kishte maturim fillestar në datën 2.6.2011, por në datën 8.11.2010 subjekti Gerti Shani e ka shitur atë me vlerë nominale 3 milionë lekë dhe shuma ka kaluar pranë Raiffeisen Bank.

3.6 Meqë kjo depozitë u krijua në vitin 2003 dhe u tërhoq nga sistemi bankar në vitin 2010, subjekti i rivlerësimit u pyet se për çfarë janë përdorur dhe kush i ka menaxhuar këto para. Subjekti ka shpjeguar⁷ se janë menaxhuar nga prindërit e tij dhe ai nuk ka përfituar asgjë nga shuma 2,869,098 lekë. Sa i takon përdorimit të kësaj shume, një pjesë të saj prindërit e kanë shpenzuar për meremetimin dhe mirëmbajtjen e shtëpisë⁸; për shpenzime të zakonshme familjare; një pjesë është depozituar sërish në sistemin bankar dhe pjesa tjetër është mbajtur si kursim në banesë. Subjekti ka specifikuar se vlerat *cash* që prindërit kanë mbajtur në shtëpi nga shuma 2,869,098 lekë, kanë qenë të ndryshme në vite të ndryshme, si 1,200,000 lekë, 1,500,000 lekë, 2,000,000 lekë e më tepër.

3.7 Sa më sipër, përdorimi i shumës 2,869,098 lekë në analizën financiare është reflektuar tek shpenzimet e jetesës⁹, një pjesë e shumës është reflektuar në rritjen e likuiditeteve në sistemin bankar¹⁰, pjesa tjetër *cash* në shtëpi. Kështu, shumat e mbajtura *cash* në shtëpi janë të mbartura. Gjithashtu, rezulton se interesat e përfituar nga investimi në bono thesari janë në vlerën bruto 1,819,144 lekë¹¹ dhe interesi i paguar për ato është 10% ose 181,914 lekë.

3.8 Për sa më sipër, përputhet deklarimi i subjektit me të dhënat bankare. Vlera neto e interesave është përfshirë si e ardhur në analizën financiare të viteve përkatëse. Komisioni nuk konstatoi problematika në lidhje me këtë pasuri.

4. Llogari bankare në Alpha Bank, hapur në datën 12.5.2003, në vlerë totale 17,000 USD, momentalisht është në vlerën 9,517.93 USD. Të ardhura të siguruara nga biznesi familjar ndër vite (bashkëlidhur nxjerrje llogarie datë 6.1.2016, si dhe datën 21.10.2016, lëshuar nga Alpha Bank, dega Lushnjë).

4.1 Subjekti i rivlerësimit i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting*: (i) mandat tërheqjeje *cash* të shumës 17,000 USD nga llogaria e datës 6.1.2016 “për investime në banesë”; (ii) nxjerrje llogarie e subjektit Gerti Shani nga Alpha Bank e datës 21.10.2016, me gjendje 9,517.93 USD.

4.2 Alpha Bank konfirmon¹² se z. Gerti Shani ka llogari pranë kësaj banke, me gjendje në datën 26.1.2017, në shumën 9,516.61 USD.

⁶ Me shkresën nr. *** prot., datë 22.12.2023, të Bankës së Shqipërisë.

⁷ Përgjigjja nr. *** e pyetësorit nr. ***.

⁸ Lyerje, ndryshim i dyerve e dritareve.

⁹ Sipas anketës së buxhetit të familjes së viteve 2007 dhe 2015 zëri “Mobilim, pajisje shtëpiake dhe mirëmbajtje të zakonshme të banesës”, përbën mesatarisht 5.65% të shpenzimeve të jetesës.

¹⁰ Në vitin 2011 ka një rritje të depozitave në dollar në Alpha Bank.

¹¹ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 23.5.2023, të Bankës së Shqipërisë, administruar në dosjen e Komisionit.

¹² Me shkresën nr. *** prot., datë 27.7.2017.

4.3 Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave konfirmon dy transaksione bankare në llogarinë nr. *** në Alpha Bank: (i) në datën 6.1.2016 “Tërheq Gerti Shani për investime në banesë” shumën 17,000 USD; (ii) në datën 30.9.2016 “Derdhje nga Gerti Shani për kursime e shumës 9,500 USD”.

4.4 Në lidhje me transaksionin e shumës 17,000 USD, subjekti ka shpjeguar në pyetësonin nr. *** se me shumën e tërhequr 17,000 USD, nuk ka bërë investim sikur ka cituar punonjësja e bankës në përshkrimin “Tërheq Gerti Shani për investime në banesë”, por një pjesë të saj e ka përdorur për blerjen e automjetit të babait në maj 2016 dhe pjesën tjetër e ka ridepozituar në bankë.

4.5 Nga verifikimi i lëvizjeve të vlerave monetare të subjektit ka rezultuar se: (i) deklaratimet e mësipërme për kohën e kryerjes së veprimeve si shumat e tërhequra e të depozituara, përputhen me faktin; (ii) shpjegimi i subjektit se përshkrimi bankar është kryer nga punonjësja e bankës duket bindës; (iii) subjekti nuk ka krijuar pasuri tjetër për periudhën janar – maj 2016. Për këto arsye, shuma e përdorur 7,500 USD është konsideruar si një nga burimet për blerjen e automjetit të babait në maj 2016.

Analiza financiare e krijimit të kësaj llogarie

4.6 Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarisë së subjektit në Alpha Bank rezulton se ajo është çelur në maj 2003 në shumën 13,000 USD dhe është aktive deri në datën kur është dorëzuar deklarata *Vetting*. Shumat e depozituara janë investuar dhe riinvestuar me kapitalizim të interesit në depozita me afat 1 – 6 mujore, deri në maj 2015. Pas kësaj date, shumat e mbetura janë mbajtur në llogarinë rrjedhëse të subjektit. Ecuria e kësaj depozite ndër vite është treguar në tabelën nr. 1.

Tabela nr. 1

Data	Balanca e llogarisë/depozitës (USD)	Veprimet e kryera gjatë vitit korrent
31.12.2003	13.044	Depozita me afat 1-mujor
31.12.2004	15.104	Depozita me afat 1-mujor
31.12.2005	6.227	Tërhequr 9.000 USD, datë 1.3.2005; shuma e mbetur depozitë 1-mujor
31.12.2006	6.315	Depozita me afat 1-mujor
31.12.2007	6.533	Depozita me afat 3-mujore
31.12.2008	6.700	Depozita me afat 3-mujore
31.12.2009	15.700	Depozituar 9.000 USD, datë 26.6.2009; shuma e krijuar depozitë me afat
31.12.2010	15.777	Depozita me afat 6-mujore
31.12.2011	16.371	Depozita me afat 6-mujore
31.12.2012	16.574	Depozita me afat 6-mujore
31.12.2013	16.802	Depozita me afat 6-mujore
31.12.2014	16.960	Depozita me afat 6-mujore
31.12.2015	17.025	Depozita me afat 6-mujore
31.12.2016	9.518	Tërhequr 7.500 USD, datë 1.6.2006; shuma e mbetur në llogari rrjedhëse
27.1.2017	9,518	Balanca në datën e deklaratës <i>Vetting</i>

4.7 Veprimet bankare që i takojnë periudhës para detyrës maj 2003 – 18.6.2015, janë pasqyruar në rubrikën e pasurive/likuiditeteve, pra janë pjesë e analizës financiare të subjektit para detyrës, e cila është kryer duke përdorur metodologjinë kumulative.

5. Analiza financiare për pasuritë e krijuara gjatë viteve 2003 – 2004

5.1 Komisioni ka kryer analizën financiare për krijimin e pasurive të trajtuara në çështjen 1 deri 4 si më lart, e cila shtrihet në periudhën gusht 1991¹³ - fundvit 2004. Nga kjo analizë duket se familja e subjektit të rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e këtyre pasurive, për shkak të një balance negative -4,833,470 lekë¹⁴.

5.2 Për sa më sipër, rezultoi se për periudhën para detyrës së subjektit, e cila përshin nga muaji gusht 1991 deri në fund të vitit 2004, familja e subjektit të rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për krijimin me të ardhura nga biznesi familjar ndër vite, të këtyre pasurive: (i) apartament në Tiranë, me vendndodhje në Rrugën *** në vlerën 2,000,000 lekë; (ii) apartament në Fier, me vendndodhje rruga “****”, me vlerë 1,000,000 lekë; (iii) llogari në Bankën e Shqipërisë, dega Lushnjë, me vlerë totale 3,300,000 lekë; (iv) llogari bankare në Alpha Bank në vlerë totale 13,000 USD.

5.3 Në lidhje me këtë konkluzion të Komisionit, subjekti ka shpjeguar në prapësimet e tij se analiza e Komisionit në lidhje me periudhën 1991 – 2004 të krijimit të pasurive është bërë në respektim të parimit të proporcionalitetit. Për periudhën 1991 – 2000, subjekti nuk ka mundur të ruajë dokumentacion për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar dhe për shkak të djegies së dokumentacionit në institucionet publike në Lushnjë gjatë ngjarjeve të vitit 1997. Subjekti është dakord me përjashtimin e pasurive të krijuara gjatë kësaj periudhe nga analiza që ka bërë Komisioni dhe me përfshirjen në analizë të të ardhurave që ai ka krijuar pas përfundimit të studimeve të larta dhe fillimit të marrëdhënieve të punës.

Përcaktimi i periudhës “para detyrës” për efekt të analizës financiare

5.4 Meqenëse për pasuritë e krijuara gjatë detyrës subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burime *kursime familjare ndër vite*, të cilat janë krijuar nga kursimet prej punës së tij, të prindërve të tij, si dhe biznesit familjar, analiza e këtyre burimeve financiare para datës 18.6.2015 bëhet imperative. Por, meqenëse pasuritë e subjektit, të krijuara deri në fund të vitit 2004, në vlerën 7,429,302 lekë, janë krijuar pa kontribut financiar të tij, u vlerësua e rëndësishme që për efekt të analizës financiare të përcaktohet cila do të konsiderohet si “periudha para detyrës së subjektit”.

5.5 Pasuritë e analizuar në çështjen nr. 1 deri nr. 4 më lart janë krijuar gjatë viteve 2003 (depozitat bankare, apartamenti në Tiranë) dhe 2004 (apartamenti në Fier), periudhë kjo kur subjekti ka qenë 22-23 vjeç dhe ndiqte studimet në Fakultetin Juridik në Tiranë, si dhe nuk gjeneronte të ardhura.

¹³ Kohë për të cilën subjekti ka vënë në dispozicion të ardhurat e prindërve të tij.

¹⁴ Pasuri 7,429,302 lekë (apartament në Tiranë, ***, blerë në datën 19.6.2003, me vlerë 2,000,000 lekë + apartament në Fier me sip. 54 m², blerë në datën 17.9.2004, me vlerë 1,000,000 lekë + likuiditete në banka me vlerë 4,429,302 lekë); të ardhura dokumentuar 4,449,257 lekë (të ardhura të babait nga pensioni i invaliditetit nga viti 1991 në vlerën 821,132 lekë + të ardhura të nënës nga PF nga janari 1994 në vlerën 238,616 lekë + të ardhura nga PF bar - kafë nga viti 2000 në vlerën 2,805,000 lekë + të ardhura nga interesa bankarë në vlerën 584,509 lekë); shpenzime 1,853,425 lekë (shpenzime jetese familjare në vlerën 1,850,625 lekë + paguar në hipotekë vlera 2,800 lekë); mundësia për kursime -4,833,470 lekë. *Sqarojmë se shpenzimet e jetesës familjare janë përlllogaritur si vijon: deri në vitin 2000 në masën 66% e të ardhurave familjare; nga viti 2000 deri në vitin 2004 sipas standardit të INSTAT-it, për 3 persona, pasi vëllai jeton në Itali qysh prej vitit 1996.*

Gjithashtu, krijimi i këtyre pasurive daton 11-12 vjet më përpara se subjekti të emërohej si ndihmës ligjor në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

5.6 Nga ana tjetër, pasuritë e mësipërme janë në emër/në pronësi të subjektit, pavarësisht moshës e mungesës së kontributit të tij financiar. Për këtë, subjekti ka sqaruar¹⁵ se babai i tij ka qenë invalid që nga viti 1991, ndërsa pas vitit 1998 ka qenë i paralizuar në karrocë invalidi dhe nuk ka dalë nga shtëpia. Meqë vëllai i subjektit, që nga viti 1996 jeton në Itali, subjekti ishte fëmija i vetëm dhe për çdo investim/shpenzim ka qenë i detyruar të vendoste emrin e vet në vend të babait, i cili ka qenë i pamundur për të lëvizur e për të qenë në një vend të caktuar për të kryer veprime juridike/bankare, ndërkohë që edhe nëna e subjektit duhej të kujdesej për babanë invalid.

5.7 Në këto rrethana, duke konsideruar se subjekti nuk ka asnjë kontribut financiar në krijimin e katër pasurive të lartpërmendura dhe nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi për burimin e ligjshëm të krijimit të tyre, Komisioni çmoi që analizën mbi burimet e këtyre katër pasurive, trajtuar në çështjen 5.1, të mos e konsiderojë si pjesë integrale të analizës financiare para periudhës së emërimit në detyrë të subjektit.

5.8 Kështu, u vlerësua që analiza financiare e subjektit për periudhën para detyrës të fillojë në vitin 2007 deri në datën 18.6.2015, pasi subjekti ka filluar të gjenerojë të ardhura dhe të krijojë pasuritë e tij me këto të ardhura që nga data 1.12.2006 kur ai është punësuar si jurist i jashtëm në N.U Lushnjë.

5.9 Kjo qasje presupozon: (i) mospërfshirjen e rezultatit negativ të periudhës 1991 – 2004 në analizën e viteve pasardhëse, pasi nuk ka logjikë financiare që për individët, balanca negative e vitit paraardhës të mbartet në vitin/et pasardhëse; (ii) përfshirjen në analizën e vitit 2007, të mundësisë për kursime për vitet 2005 dhe 2006, të cilat kanë rezultuar me balanca pozitive; (iii) gjendja e likuiditeteve në fund të vitit 2007 në vlerën 3,280,831 lekë, e cila është krijuar dhe mbartet qysh nga viti 2003 dhe vijon të jetë në sistemin bankar edhe në vitin 2007, të mos konsiderohet si një pasuri e fituar me burime të ligjshme.

5.10 Sipas kësaj analize, mundësia për kursime është 6,362,512 lekë, e cila shërben si e *ardhur nga periudhat e kaluara* në analizën financiare të subjektit gjatë ushtrimit të detyrës së tij, sipas tabelës nr. 2.

Tabela nr. 2

Përshkrimi (në lekë)	2007 – 18.6.2015
Pasuri	3,978,325
Automjet tip “****”, AA ***, babai 24.5.2010 – 4.000 euro	555,240
<i>Shtesa/pakësime likuiditeteve</i>	<i>3,423,085</i>
Gjendja e likuiditeteve	3,423,085
Të ardhura dokumentuar	15,702,905
Të ardhura të babait nga pensioni i invaliditetit, nga 1/2007	1,333,203
Ndihmë nga Bashkia për të sëmuret, babai nga 10/2008	3,043,430
Të ardhura të nënës nga pensioni nga 2/2010	881,742
Të ardhura subjekti si jurist i jashtëm Ujësujllësi Lushnjë nga 01/2007	3,867,637

¹⁵ Përgjigjja nr. *** e pyetësorit nr. ***.

Të ardhura subjekti si PF si avokat nga 01/2008	3,159,653
Të ardhura nga interesa bankarë	918,699
Të ardhura nga periudha të kaluara	2,498,541
Shpenzime	5,362,068
Shpenzime jetese për 3 persona	3,915,069
Shpenzime udhëtimi sipas sistemit TIMS	806,353
Shpenzime të tjera të evidentuara	640,645
Mundësia për kursime kumulative	6,362,512

Deklarimet e subjektit për pasuritë e krijuara pas detyrës

6. Kontratë sipërmarrjeje për prenotim apartamenti me sipërfaqe totale 101 m² dhe sipërfaqe neto 91 m², në vlerë totale 31,310 euro, i ndodhur në lagjen “****”, Lushnjë, me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.10.2015, e redaktuar nga notere publike G.N. Të ardhura të siguruara nga ushtrimi i aktivitetit, i profesionit të avokatit me nr. *** NUIS, juristit të jashtëm dhe biznesi familjar ndër vite (bashkëlidhur këtij deklarami kontrata e sipërmarrjes, mandati bankar datë 24.10.2015, i lëshuar nga Credins Bank, dega Lushnjë, si dhe mandati bankar i lëshuar nga BKT-ja, dega Lushnjë, datë 19.9.2016). Vlera totale e kontratës 31,310 euro. Është paguar në datën 24.10.2015, vlera 910,000 lekë që i korrespondon vlerës 6,500 euro. Është paguar në datën 20.9.2016, vlera 686,000 lekë, që i korrespondon vlerës 5,000 euro. Janë për t’u paguar shuma e mbetur prej 19,810 euro. Pjesa takuese: 50%.

6.1 Kjo pasuri është deklaruar njësoj në deklaratën *Vetting* edhe nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, znj. R.Sh.

6.2 Në rubrikën “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë” të deklaratës *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Detyrim i papaguar për kontratën e sipërmarrjes për prenotim apartamenti me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.10.2015, në vlerë totale 31,310 euro, vlera e mbetur pa paguar 19,810 euro*”.

Hetimi i kryer nga Komisioni

- i) Subjekti i rivlerësimit i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* kontratë sipërmarrjeje për prenotim apartamenti datë 24.10.2015¹⁶, në të cilën pala sipërmarrëse (investitor) V.L dhe shoqëria “****” sh.p.k. merr përsipër të ndërtojë dhe më pas t’ia shesë porositësve Gerti Shani e R.B apartamentin nr. ****, kati *** i banimit, me sip. totale 101 m², kundrejt çmimit 31,310 euro, i cili është paguar pjesërisht me këste sipas mandateve: (a) mandatpagesë datë 24.10.2015 nga Credins Bank për xhirim shume 910,000 lekë “Pagesë kësti për blerje apartamenti” nga shtetasit Gerti Shani e R.B (Sh) për shoqërinë “****” sh.p.k.; (b) mandatpagesë datë 19.9.2016 nga BKT-ja për xhirim shume 686,000 lekë “Pagesë kësti për blerje apartamenti” nga shtetasit Gerti Shani e R.B (Sh) për shoqërinë “****” sh.p.k.
- ii) Kërkesë datë 17.10.2016 që subjekti i rivlerësimit i ka dërguar Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier, dega Lushnjë, për informacion mbi të ardhurat që ka deklaruar pranë kësaj drejtorie personi fizik “****”, me NIPT ****, me aktivitet “bar-bufe”, në vitet 1991 – 2000.

¹⁶ Kontratë sipërmarrjeje për prenotim apartamenti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.10.2015, noter G.N .

6.3 Në lidhje me këstin e tretë prej 19,810 euro të çmimit të apartamentit, për të cilin në kontratën e sipërmarrjes palët kanë rënë dakord që të paguhet sipas një marrëveshjeje midis tyre, Komisioni e ka pyetur subjektin nëse ka nënshkruar një marrëveshje të tillë dhe a është paguar kjo diferencë? Nëse po, të provojë me dokumentacion ligjor kur e ka paguar. Nëse jo, të shpjegojë në çfarë rrethanash dhe për çfarë arsye kjo shoqëri e ka favorizuar për kohën e pagesës së këstit të fundit 19,810 euro? Çfarë lidhje/njohje ka me drejtuesit e kësaj shoqërie? Gjatë ushtrimit të detyrës, a ka ndjekur ndonjë çështje ligjore me shoqërinë “****” sh.p.k. apo drejtuesit ligjor të saj dhe, për të provuar këtë, të paraqesë vërtetim nga institucionet ku ka punuar.

6.4 Në përgjigje¹⁷, subjekti i rivlerësimit ka dhënë të njëjtin shpjegim, si dhe shoqëria “****” sh.p.k.¹⁸ se nuk është paguar asnjë diferencë e mbetur, pasi objekti nuk është regjistruar në ASHK Lushnjë që të bëhet veprimi juridik final për kalimin e pronësisë. Në vijim, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar¹⁹ se me përfaqësuesin e shoqërisë “****” sh.p.k. nuk ka asnjë njohje personale dhe direkte, thjesht si subjekt privat i njohur në qytetin e Lushnjës, në kohën kur ka ushtruar veprimtarinë si avokat në këtë qytet, si dhe nuk ka ndjekur asnjë çështje të kësaj shoqërie e nuk e ka përfaqësuar as kur ushtronte profesionin e avokatit në qytetin e Lushnjës.

6.5 Referuar udhëzimit nr. 4, datë 30.9.2015, të EKB-së, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2015”, rezultoi se çmimi i apartamentit është më i lartë se çmimi referencë²⁰.

6.6 Nisur nga fakti që subjekti i rivlerësimit nuk ka njohje dhe nuk ka dhënë opinion për çështje gjyqësore të shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k. dhe faktit që çmimi i blerjes së apartamentit është më i lartë se çmimi referencë, atëherë Komisioni konkludoi se subjekti nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, si dhe nuk është favorizuar në çmimin e blerjes.

6.7 ZVRPP Lushnjë ka konfirmuar²¹ se shtetasit Gerti dhe R.Sh nuk kanë pasuri të paluajshme të regjistruar në emër të tyre. Gjithashtu, ASHK Drejtoria Vendore Lushnjë nuk konfirmon²² që në emër të shtetasit Gerti e R.Sh të jetë të regjistruar apartament me sip. 101 m².

6.8 DPPPP-ja ka konfirmuar²³ se shtetasi Gerti Shani në datën 24.10.2015 ka porositur apartament me sip. 100 m², në lagjen “****” në shumën 31,310 euro. Palë sipërmarrëse është shtetasi D. S, përfaqësues i shoqërisë “****” sh.p.k. Burim i fondeve të deklaruara: avokati dhe punësim, vlera e 50 m² do të pranohet dhurim nga shtetasi R.B.

6.9 Meqë subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar në deklaratën *Vetting* këtë dhurim si burim financiar për krijimin e apartamentit, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit që të shpjegojë: (i) marrëdhënien e tij me shtetasin R.B, rrethanat e njohjes mes tyre, nëse ka ndjekur ndonjë çështje ligjore me këtë shtetas gjatë ushtrimit të detyrës. Nëse po, të paraqesë vërtetim nga institucionet ku ka punuar; (ii) cili është pozicioni i këtij shtetasi në shoqërinë “****” sh.p.k.; (iii)

¹⁷ Përgjigjja nr. *** e pyetësorit nr. ***.

¹⁸ Shkresa nr. *** prot., datë 16.10.2023, e shoqërisë “****” sh.p.k., drejtuar Komisionit.

¹⁹ Përgjigjja nr. *** e pyetësorit nr. ***.

²⁰ Sipas EKB-së, ky çmim është 40,100 lekë/m² dhe për sip. 101 m², vlera e apartamentit do të ishte 4,050,100 lekë. Kursi i këmbimit të euros në datën 23.10.2015 ka qenë 139.45 x 31,310 = 4,366,179 lekë. Pra, ky apartament është blerë 316,079 lekë më shtrenjtë sesa çmimi referencë.

²¹ ZQRPP-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 5.10.2017, ka bashkëlidhur përgjigjen e ZVRPP-së Lushnjë nr. *** prot., datë 27.9.2017. Aneksi nr. *** i dosjes *Vetting*.

²² Me shkresën nr. *** prot., datë 23.6.2023, e ASHK Lushnjë, drejtuar Komisionit.

²³ Me shkresën nr. *** prot., datë 27.4.2017, në Aneksin nr. *** të dosjes *Vetting*.

cila është vlera që ky shtetas i ka dhuruar subjektit të rivlerësimit dhe data e dhurimit? Të depozitohet për këtë fakt dokumentacionin ligjor përkatës; (iv) përse nuk e ka deklaruar në deklaratën *Vetting* këtë dhurim si burim financiar për blerjen e apartamentit.

6.10 Në përgjigje²⁴, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se:

i) Shtetasi R.B është xhaxhai i bashkëshortes së tij, R.Sh (B) dhe nuk ka pasur asnjë çështje apo proces gjyqësor me këtë shtetas gjatë ushtrimit të detyrës apo edhe gjatë ushtrimit të profesionit të avokatit në qytetin e Lushnjës (bashkëlidhur certifikatë martesë e subjektit datë 7.10.2023, certifikatë familjare datë 5.10.2023 e bashkëshortes R.Sh; subjekti ka aplikuar në e-albania edhe për certifikatën e gjendjes familjare të vitit 1960 të vjehrrit të tij N.B, por certifikata nuk i është dërguar në e-albania bashkëlidhur konfirmim *email*-i për aplikim në e-albania datë 7.10.2023²⁵).

ii) Shtetasi R. B është në pozitën e pronarit të truallit me shoqërinë ndërtuese “****” sh.p.k., referuar kontratës shtesë sipërmarrjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.6.2014, për caktimin e pjesëve në natyrë pronar truall-investitor, e nënshkruar midis kësaj shoqërie dhe pronarëve të truallit, përfshirë edhe pronarin R.B (bashkëlidhur është kjo kontratë). Ky shtetas nuk i ka dhuruar asgjë subjektit të rivlerësimit referuar përmbajtjes së deklaratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.10.2015. Bashkëlidhur, subjekti e ka depozituar këtë deklaratë, ku shoqëria “****” sh.p.k. është dakordësuar me vullnetin e shtetasit R.B, i cili deklaron se: *“Ka hequr dorë nga një apartament nr. ***, kati ***, me sip. 148.6 m² bruto dhe 136.6 m² sipërfaqe neto që e ka përzgjedhur sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.6.2014. Këtë apartament ia dhuron në mënyrë të barabartë familjarëve të vëllait të tij N.B (bashkëshortes E.B, vajzës R.B dhe djalit J.B). Shoqëria “****” sh.p.k., vlerën korresponduese të këtij apartamenti ta konsiderojë të shlyer nga këta persona për këstet e pashlyera nga ata në dy kontratat e sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.10.2015 dhe nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.10.2015, që shoqëria cka lidhur me ata. Pas regjistrimit të kësaj deklarate, shoqëria “****” sh.p.k. do të lëshojë deklaratën e shlyerjes së çmimit për kontratat respektive” (bashkëngjitur kontrata e pronotimit të apartamentit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.10.2015).*

iii) Deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.10.2015, të shtetasit R.B, subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar, pasi ai vetë nuk përfshihet në përmbajtjen e kësaj deklarate të nënshkruar midis shtetasit R.B dhe shoqërisë “****” sh.p.k. Gjatë diskutimeve të bëra midis subjektit të rivlerësimit, bashkëshortes së tij R.Sh, kunatit J.B dhe vjehrrës E.B me përfaqësuesit e shoqërisë “****” sh.p.k., janë dakordësuar që apartamenti me sipërfaqe totale 148.6 m², nga i cili hoqi dorë R.B, të mos merrej në dorëzim dhe në vend të tij të merreshin dy apartamente secili 101 m², në total 202 m² dhe për diferencën e sip. 53.4 m² të paguhej diferenca e çmimit. Dy apartamentet secili 101 m² u dorëzuan nga shoqëria “****” sh.p.k., me kushtin që do të vijohet me nënshkrimin e kontratave të sipërmarrjes për pronotim sikurse për çdo njësi tjetër që shitej nga kjo shoqëri. Në vijim, subjekti i rivlerësimit ka kryer dy pagesa në vlerën: 910,000 lekë (ose 6,500 euro) në datën 24.10.2015 dhe 686,000 lekë (ose 5,000 euro) në datën 20.9.2016, ndërsa pjesa tjetër e mbetur do të paguhej në përfundim të regjistrimit të objektit në ASHK kur të kalohej

²⁴ Përgjigje nr. *** e pyetësorit nr. ***.

²⁵ Nga regjistri kombëtar i gjendjes civile, Komisioni konstatoi se R.B ka atësi, mëmësi dhe vendlindje të njëjtë me vjehrrin e subjektit të rivlerësimit N.B, pra janë vëllezër dhe provohet pohimi i subjektit për këtë fakt.

pronësia midis shoqërisë “***” sh.p.k. dhe subjektit Gerti Shani dhe të llogaritej shuma finale e mbetur.

6.11 Referuar akteve noteriale të lartpërmendura, si dhe shpjegimeve të subjektit, duket se një pjesë e apartamentit me sip. 101 m² që ka përfituar ai dhe bashkëshortja, është dhuratë nga xhaxhai i bashkëshortes së tij, z. R.B. Në këto kushte, referuar edhe kontratës së sipërmarrjes së apartamentit datë 24.10.2015, e cila është nënshkruar nga subjekti dhe bashkëshortja e tij si bashkëporositës, të cilët më pas kanë paguar edhe dy këste të vlerës kontraktore, meqenëse një pjesë e sipërfaqes së tij ka si burim krijimi dhurimin nga xhaxhai i bashkëshortes dhe meqenëse kjo është një pasuri e deklaruar dhe aktuale në *Vetting*, atëherë subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin ta deklaronte këtë dhurim.

Analiza financiare e burimit të krijimit të kësaj pasurie

6.12 Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura: (i) nga ushtrimi i profesionit të avokatit me nr. *** NUIS; (ii) si jurist i jashtëm; (iii) nga biznesi familjar ndër vite.

6.13 Në lidhje me burimin “Të ardhurat nga ushtrimi i profesionit të avokatit”, subjekti i rivlerësimit i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting*: (i) ekstraktin datë 15.10.2016 nga QKB-ja për personin fizik “G.Sh”; (ii) vërtetim nr. ***, datë 17.10.2016, nga Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore të Bashkisë Lushnjë; (iii) dy shkresa²⁶ të Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier.

6.14 QKB-ja ka konfirmuar²⁷ regjistrimin e personit fizik “G.Sh” në datën 10.10.2008, me objekt “Zyrë avokatie”, me NIPT ***, me status i çregjistruar në datën 14.9.2015 dhe ka dërguar bashkëlidhur ekstraktin e regjistrit tregtar datë 11.7.2017 të këtij personi fizik.

6.15 Drejtoria Rajonale Tatimore Fier konfirmon²⁸ regjistrimin e personit fizik “G.Sh” me aktivitet “avokat”, i cili si tatimpagues është me përgjegjësi tatimore për tatim-fitimin e thjeshtuar, tatimin mbi vlerën e shtuar, tatimin e mbajtur në burim, kontributet për sigurimet shoqërore e shëndetësore, si dhe ka deklaruar për vitet 2011 – 2015 të ardhurat dhe fitimin pas tatimit. Bashkëlidhur janë depozituar edhe formularët e deklarimit dhe pagesa e tatimit mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël për vitet 2012 – 2016.

6.16 Drejtoria e të Ardhurave Vendore në Bashkinë Lushnjë konfirmon²⁹ se personi fizik “G.Sh”, me aktivitet “avokat” ka deklaruar vlerën e xhiros së tatueshme për vitet 2008 – 2010³⁰, ndërsa për vitet 2011 – 2013 nuk ka kryer deklarime. Shkresa nuk ka të dhëna për fitimin e personit fizik.

6.17 DRT Fier konfirmon³¹ se subjekti “G.Sh”, me NIPT ***, është regjistruar pranë kësaj drejtorie në datën 10.1.2008, me objekt veprimtarie “aktivitete juridike” dhe është çregjistruar në datën 14.9.2015. Ky subjekt është regjistruar me përgjegjësi tatimore për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin, tatimin mbi të ardhurat personale për biznesin e vogël, TVSH-në, tatimin e mbajtur në

²⁶ Shkresat nr. *** prot., datë 24.1.2017 dhe nr. *** prot., datë 11.10.2016, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier.

²⁷ Me shkresën nr. *** prot., datë 26.5.2023, të QKB-së, drejtuar Komisionit.

²⁸ Me shkresat nr. *** prot., datë 14.8.2017 dhe nr. *** prot., datë 28.6.2017.

²⁹ Me shkresën nr. *** prot., datë 27.7.2017.

³⁰ Xhiroja për vitin 2008 ka qenë 300,000 lekë, për vitin 2009 në vlerën 450,000 lekë dhe në vitin 2010 në vlerën 1,067,000 lekë.

³¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 5.6.2023, të DRT Fier, drejtuar Komisionit.

burim, kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, si dhe ka realizuar qarkullim e fitim për vitet 2011 – 2015.

6.18 ISSH konfirmon³² pagat bruto dhe sigurimet shoqërore për personin fizik “G.Sh” me NIPT *** për periudhën mars 2012 – qershor 2015.

6.19 Për shkak të disa mospërputhjeve që u identifikuan midis shkresave të mësipërme, u kërkua nga DRT Fier saktësimi i të dhënave mbi qarkullimin dhe fitimin e personit fizik “G.Sh” për vitet 2008 – 2015. Në përgjigje³³ janë konfirmuar të dhënat e sakta për vitet 2011 – 2015, ndërsa për vitet 2008 – 2010 nuk ka informacion sepse përlllogaritja dhe mbledhja e detyrimeve për këtë periudhë ka qenë në administrimin e qeverisjes vendore.

6.20 Bazuar në të gjithë informacionin si më lart, duke kombinuar të dhënat e përcjella nga DRT Fier dhe Bashkia Fier, është përlllogaritur fitimi i personit fizik “G.Sh”, për ato vite që mungojnë, sikurse treguar në tabelën nr. 3.

Tabela nr. 3

Vitet	Qarkullimi (lekë)	Fitimi i informuar/ * i përlllogaritur (lekë)
2008	300,000	240,000*
2009	450,000	360,000*
2010	1,067,000	853,600*
2011	297,495	205,404
2012	693,328	310,420
2013	434,989	245,247
2014	641,651	616,651
2015	340,831	328,331
Total	4,225,294	2,831,322

6.21 Meqenëse për periudhën 2008 – 2010 disponohen vetëm të dhënat mbi qarkullimin e personit fizik, Komisioni ka përlllogaritur fitimin e kësaj periudhe, duke aplikuar një normë fitimi në masën 80%, bazuar në standardin e përdorur në raste të tjera të ngjashme nga Komisioni.

6.22 Të ardhurat në shumën totale 2,831,322 lekë, të përfituara nga personi fizik “G.Sh”, me aktivitet “avokati” janë përfshirë në analizën financiare, si të ardhura të ligjshme të subjektit, për vitet në të cilat ato janë krijuar.

6.23 Në lidhje me burimin “të ardhurat nga biznesi familjar ndër vite”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën Vetting: “Të ardhura nga biznesi “bar-bufe” me nr. ***, për vitet 2000 – 2006, i ndodhur në lagjen “***” (bashkëngjitur këtij deklarami vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, nr. ***, datë 12.4.2000, vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë nr. ***, datë 27.10.2006, vërtetim nr. *** prot., datë 24.1.2017, lëshuar nga Drejtoria e Tatimeve Rajonale Fier). Për vitet 2000 – 2003 nuk ka informacion nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Fier, për vitin 2003 qarkullim i deklaruar 1.200.000 lekë; për vitin 2004 qarkullim i deklaruar 1.200.000 lekë, për vitin 2005 xhiroja e vlerësuar 1.600.000 lekë, për vitin 2006 xhiro e vlerësuar 2.000.000 lekë” dhe i ka bashkëlidhur deklaratës Vetting, (i) vendimin nr. ***, datë 12.4.2000, të

³² Me shkresën nr. *** prot., datë 25.5.2023, drejtuar Komisionit.

³³ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 4.1.2024, nga DRT Fier, e administruar në dosjen e Komisionit.

Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë për regjistrimin e personit fizik “G.Sh” me objekt “Bufe”; (ii) vendimin nr. ***, datë 27.10.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë për transferimin e emrit të këtij personi fizik tek vëllai i subjektit të rivlerësimit, shtetasi A.Sh; (iii) shkresën nr. *** prot., datë 24.1.2017, të Drejtorisë Rajonale Tatimore (DRT) Fier, që konfirmon regjistrimin e personit fizik “****” aktivitet “bar-bufe”, me NIPT ***, që ka deklaruar për vitet 2003 – 2006 vlerat e qarkullimit vjetor dhe fitimin e tatueshëm për çdo vit.

6.24 Gjithashtu edhe nëna e subjektit të rivlerësimit, znj. Th.Sh, ka deklaruar në deklaratën *Vetting*: “*Të ardhura nga biznesi “bar-bufe” me NIPT ***, për vitet 1991 – 2000, i ndodhur në lagjen “****” (bashkëngjitur vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë nr. ***, datë 12.4.2000). Nuk kam informacion nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, pas kërkesës së bërë në datën 17.10.2016”.*

6.25 DRT Fier³⁴ konfirmon se shtetasja Th.Sh nuk ka qenë e regjistruar si tatimpaguese pranë këtij organi tatimor deri në datën 31.5.2023.

6.26 QKB konfirmon³⁵ regjistrimin e personit fizik “****” me objekt “Bufe” me NIPT ***, që nga data 1.10.2008, i cili rezulton me status i çregjistruar në datën 23.3.2012.

6.27 Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve konfirmon³⁶ regjistrimin e personit fizik “G.Sh” me aktivitet “Bufe” me NIPT *** pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier, Agjencia Tatimore Lushnjë që nga data 30.5.2000.

6.28 DRT Fier konfirmon³⁷ se shtetasi Gerti Shani është i regjistruar si person fizik me NIPT ***, me aktivitet “Bufe”, në datën 30.5.2000, me vendim gjykate nr. ***, datë 12.4.2000, me përgjegjësi tatimore tatim-fitimi i thjeshtuar, kontribute të sigurimeve shoqërore, si dhe ka realizuar qarkullim e fitim për vitet 2000 – 2006. Subjekti e ka transferuar NIPT-in tek shtetasi A.Sh me vendim gjykate nr. ***, datë 27.10.2006.

6.29 FSHU-ja konfirmon se në emër të shtetasës Th.Sh është lidhur në datën 11.6.2005 kontratë private nr. **. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjatë hetimit³⁸ se kjo kontratë i përkiste biznesit familjar “bar-bufe” me NIPT ***, në lagjen “****” Lushnjë, aktivitet i zhvilluar në vitet 1991 – mars 2012 kur është mbyllur kjo kontratë. (bashkëngjitur fatura energjisë e muajit mars 2012, që i përket kësaj kontrate me subjekt Th.Sh, si dhe detaje të pagesës së konsumatorit të nxjerra nga sistemi i OSHEE, dega Lushnjë, 3 fletë).

6.30 I pyetur nga Komisioni nëse familja e tij ka përfituar të ardhura nga ky biznes pas datës kur biznesi është transferuar në emër të vëllait të tij A.Sh, subjekti ka shpjeguar³⁹ se ky biznes që prej vitit 1991 kur lokali shtetëror është privatizuar e deri në mars 2012 kur është mbyllur përfundimisht, është punuar dhe administruar gjatë gjithë kohës nga nëna e tij Th.Sh, siç rezulton nga kontrata e energjisë elektrike. Subjekti i rivlerësimit e ka ndihmuar nënën e tij Th.Sh në menaxhimin dhe administrimin e lokalit në periudha kohe të caktuara. Të ardhurat e gjeneruara prej këtij aktiviteti janë përfituar dhe mbajtur nga familja pavarësisht në emër të kujt ka qenë

³⁴ Sipas shkresës nr. *** prot., datë 5.6.2023, të DRTatimore Fier, drejtuar Komisionit.

³⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 17.7.2017, me ekstraktin e regjistrimit tregtar datë 18.9.2017 dhe ekstraktin historik datë 2.10.2023.

³⁶ Me shkresën nr. *** prot., datë 29.5.2023, të DPrTatimeve, drejtuar Komisionit.

³⁷ Me shkresën nr. *** prot., datë 5.6.2023, të DRT Fier, drejtuar Komisionit.

³⁸ Në përgjigjen nr. *** të pyetësorit nr. ***.

³⁹ Përgjigja nr. *** e pyetësorit nr.***.

licenca e aktivitetit. Familja përbëhej nga subjekti Gerti Shani, babai, nëna dhe vëllai i tij A. Sh, i cili jeton në Itali që nga viti 1996, referuar të dhënave nga INPS Itali. Në deklaratën *Vetting* është deklaruar se të ardhurat financiare janë kursimet familjare dhe të ardhurat nga biznesi. Të ardhurat e gjeneruara nga biznesi “bar-kafe” janë të deklaruara edhe në Drejtorinë Rajonale Tatimore Fier (bashkëngjitur informacioni deklaratës *Vetting*), megjithëse nuk janë të plota dhe për periudhën 1991 – 2000 ky institucion nuk ka të dhëna.

6.31 Për shkak të disa mangësive në dokumentacionin e administruar, u kërkua nga DRT Fier saktësimi i informacionit për personin fizik “G.Sh”, me aktivitet “Bar”, për vitet 2000 – 2006, ku të pasqyrohej fitimi dhe tatim-fitimi i thjeshtuar. Në përgjigje⁴⁰, DRT Fier ka saktësuar të dhënat për tatimin mbi fitimin e thjeshtuar për vitet 2000 – 2006, sikurse treguar në tabelën nr.4.

Tabela nr. 4

Vitet	Qarkullimi (në lekë)	Tatim mbi fitimin e thjeshtuar (në lekë)	Fitimi (i përlogaritur)
2000	900,000	23,472	495,000
2001	1,300,000	40,000	715,000
2002	500,000	40,000	275,000
2003	1,200,000	59,040	660,000
2004	1,200,000	48,000	660,000
2005	1,600,000	45,391	880,000
2006	2,000,000	30,000	1,100,000
Total	6,700,000		4,785,000

6.32 Meqenëse fitimi i këtij biznesi nuk është informuar nga DRT Fier, ai është përlogaritur nga Komisioni si në kolonën e fundit të tabelës nr. 7 në fund të vendimit, duke u konsideruar një normë fitimi për aktivitetin “bar-kafe” në masën 55%, mbështetur në praktikën e Komisionit në raste të ngjashme.

6.33 Të ardhurat e përfituara nga personi fizik “G.Sh”, me aktivitet “bar”, në shumën totale prej 4,785,000 lekësh, janë përfshirë në analizën financiare si të ardhura të ligjshme të subjektit, për vitet në të cilat ato janë krijuar.

6.34 Në pyetësin nr. ***, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar⁴¹ se në deklaratën *Vetting* është pasqyruar se të ardhurat financiare janë kursimet familjare dhe të ardhurat nga biznesi. Në kursimet familjare, shpjegon subjekti, janë edhe të ardhura nga remitancat (kursimet) që ka dërguar vëllai i tij A.Sh në vitet 1996 – 2005, të dërguar pranë familjes dhe që menaxhoheshin nga familja, (bashkëngjitur *busta paga* e shtetasit A.Sh, i datëlindjes 12.6.1972, karta identitetit italiane e A.Sh, si dhe certifikata familjare gjendja viti 2004 me vëllain A.Sh në përbërje).

6.35 Bazuar në këtë përgjigje, duket se subjekti e ka saktësuar më tej burimin “Kursime familjare në vite” duke përfshirë edhe remitancat e vëllait nga Italia për vitet 1996 – 2005, por nuk ka përcaktuar vlerat monetare konkrete të sjella nga vëllai si gjatë viteve 1996 – 2005 ashtu edhe në

⁴⁰ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 4.1.2024, nga DRT Fier, e administruar në dosjen e Komisionit.

⁴¹ Përgjigja nr. *** e pyetësin nr. ***.

vijim. Për këtë, Komisioni i kërkoi subjektit që të shpjegojë specifikisht se çfarë vlerash monetare ka sjellë vëllai i tij, periudhën kur i ka sjellë dhe mënyrën e prurjes së tyre nga Italia.

6.36 Në përgjigje⁴², subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se vëllai ka sjellë vlera monetare tek prindërit gjatë verës apo festave zyrtare kur vinte në Shqipëri për pushime apo nëpërmjet të tretëve kur ata vinin me pushime, por sidoqoftë ai deklaroi se nuk mund të përcaktojë në mënyrë të saktë vlerën e këtyre prurjeve pasi kursimet e tij vëllai ua dërgonte prindërve.

6.37 Gjithashtu, subjekti shpjegoi⁴³ se është në pamundësi objektive për të deklaruar shumën e saktë sepse ka kaluar kohë e gjatë që as nëna, as vëllai nuk mund t'i japin shifra të sakta.

6.38 Referuar dokumentacionit të paraqitur nga subjekti mbi të ardhurat e vëllait A.Sh në Itali, rezultoi se vëllai ka pasur të ardhura të ligjshme prej 335.152 euro⁴⁴ për periudhën 1996 – 2016.

6.39 Pavarësisht se nga dokumentet e paraqitura për vëllain A.Sh rezultoi se ka pasur të ardhura të konsiderueshme, sërish prurjet e vëllait nuk mund të përfshihen si të ardhura në analizën financiare të subjektit dhe prindërve të tij, pasi subjekti nuk ka specifikuar vlerën e të ardhurave që ka dërguar vëllai. Në këto kushte, Komisioni nuk kreu ndonjë analizë financiare mbi mundësinë e vëllait për të sjellë shuma të caktuara në Shqipëri.

6.40 Në lidhje me burimin “Të ardhurat si jurist i jashtëm”, subjekti i ka bashkëlidhur deklaratën *Vetting*: (i) vërtetim punësimi datë 17.10.2016 dhe pagën mujore nga Njësia Administrative R, Bashkia Divjakë për periudhën 1.3.2014 – 31.5.2015; (ii) vërtetim punësimi datë 10.10.2016 dhe pagën neto totale nga Ujësjetës Fshat Lushnjë për periudhën 1.12.2006 – 18.6.2015. Nga këto dokumente ka rezultuar se vlera totale e të ardhurave të subjektit për periudhën 1.12.2006 – 31.5.2015, është 3,892,707 lekë. Këto të ardhura janë përfshirë në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit për vitet/periudhat përkatëse.

6.41 Sa i takon mundësinë financiare të subjektit për të paguar për apartamentin shumat 910,000 lekë në datën 25.10.2015; 686,000 lekë (5,000 euro) në datën 20.9.2016, nga të ardhura të ligjshme që ka përfituar ndër vite, para e gjatë detyrës, Komisioni kreu analiza financiare sikurse është pasqyruar në tabelën nr. 7 në fund të vendimit për periudhat 18 qershor deri më 31.12.2015 dhe viti 2016.

6.42 Analiza për këto dy periudha është kryer duke përdorur metodologjinë kumulative, pasi subjekti nuk ka qenë subjekt i deklarimit vjetor pranë ILDKPKI-së, por ka deklaruar vetëm në deklaratën *Vetting*. Në zërin “Kursime të mbartura nga periudha të kaluara” është pasqyruar mundësia për kursime e subjektit dhe familjes së tij për periudhën 2007 – 18.6.2015, e cila ka rezultuar me balancë pozitive prej 6,362,512 lekësh⁴⁵. Në analizë nuk janë përfshirë si të ardhura të ligjshme prurjet e vëllait nga Italia, për arsytet që janë trajtuar më sipër⁴⁶.

⁴² Përgjigja nr. *** e pyetësorit nr. ***.

⁴³ Përgjigja nr. *** e pyetësorit nr. ***.

⁴⁴ Konkretisht për periudhën e viteve 1996 – 2005 të deklaruar nga subjekti në pyetësorin nr. *** si periudhë kur vëllai ka sjellë vlera monetare tek prindërit në Shqipëri të ardhurat neto janë në shumën 101,901 euro; ndërsa për periudhën 2006 – 2016 në shumën 233,252 euro.

⁴⁵ Trajtuar në çështjet 5.4 – 5.10 të këtij vendimi.

⁴⁶ Trajtuar në çështjet 6.34 - 6.39 të këtij vendimi.

6.43 Sipas kësaj analize, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi për të paguar këstet e apartamentit përkatësisht në vitet 2015 e 2016.

6.44 Për sa më lart, Komisioni konkludoi se në deklaratën *Vetting* subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar dhurimin e një sipërfaqeje ndërtimi nga xhaxhai i bashkëshortes së tij, si burim krijimi i një pjese të apartamentit me sip. 101 m², që subjekti dhe bashkëshortja disponojnë në deklaratën *Vetting*. Për këtë, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 për konstatimin e lartpërmendur.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me barrën e provës

6.45 Në prapësimet e tij, subjekti i rivlerësimit ka dhënë të njëjtat shpjegime si edhe gjatë hetimit, duke theksuar se sipas deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.10.2015, shtetasi R.B ka disponuar një të drejtë në favor të familjarëve të vëllait të tij (E, J dhe R.B) dhe nuk ka disponuar ndonjë të drejtë në favor të subjektit të rivlerësimit. Referuar deklaratës, është përcaktuar se pas regjistrimit të kësaj deklarate shoqëria “****” sh.p.k. duhet të lëshojë edhe deklaratën e shlyerjes së çmimit për të dyja kontratat respektive të sipërmarrjes për prenotim apartamenti. Në vijim, subjekti shpjegon se një prej këtyre kontratave të sipërmarrjes është edhe kontrata nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.10.2015, e nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit si palë porositëse. Në këtë kontratë, palët kanë përcaktuar se çmimi i objektit duhet të paguhet me këste dhe për këstin e tretë që përbëhet nga diferenca midis çmimit total dhe vlerës së kësteve të paguara kanë deklaruar se afatin për pagesën e këtij kësti palët do ta caktojnë me marrëveshje midis tyre. Në kontratë, palët kanë deklaruar edhe se me përfundimin total të punimeve, pala sipërmarrëse do të bëjë regjistrimin e godinës pranë ZVRPP-së Lushnjë dhe më pas do të realizojë kontratën definitive të shitblerjes së ambientit të hipotekuar.

6.46 Subjekti shpjegon në vijim se vlera e mbetur pasi ka paguar dy këstet e çmimit të apartamentit do të paguhej kur të kalohej pronësia midis shoqërisë “****” sh.p.k. e subjektit Gerti Shani dhe të llogaritej shuma e mbetur në përfundim të regjistrimit të objektit në ASHK. Nga ana e subjektit nuk është paguar vlera e mbetur, prandaj nuk është deklaruar “dhurimi” si burim financiar për blerjen e apartamentit me sip. 101 m². Gjithashtu, deklarata noteriale datë 24.10.2015 nuk figuron e regjistruar dhe, për këtë arsye, nuk është lëshuar nga shoqëria “****” sh.p.k. deklarata e shlyerjes së çmimit. Sa më sipër, “dhurimi” si burim financiar (nëpërmjet deklaratës së datës 24.10.2015) do të pasqyrohet në vijim të pagesës së këstit të mbetur, e provuar kjo me deklaratën e shlyerjes së çmimit që do të lëshojë shoqëria “****” sh.p.k. Pra, subjekti i rivlerësimit nuk ndodhet në situatën e mosdeklarimit të “dhurimit të një sipërfaqeje ndërtimi nga R.B” si burim i krijimit të një pjese të apartamentit me sip. 101 m² sepse kontrata e sipërmarrjes e nënshkruar nga subjekti Gerti Shani është në fuqi sepse nuk ka vijuar me pagesën e këstit të mbetur dhe nuk është realizuar kontrata definitive e shitblerjes së apartamentit ende të pahipotekuar. Në momentin e realizimit të kontratës së shitblerjes kur do të llogaritej shuma finale, e mbetur pa shlyer, dhe do të lëshohet deklarata e shlyerjes së çmimit, do të referohet edhe dhurimi si burim krijimi.

Vlerësimi i Komisionit

6.47 Në prapësimet e tij duket se subjekti i rivlerësimit e lidh detyrimin e deklarimit të “dhurimit” me afatin kur do të regjistrohet deklarata noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.10.2015, dhe kur do të paguhej diferenca e mbetur e çmimit të apartamentit që kishte porositur, prandaj edhe

pretendon që meqenëse nuk janë kryer këto veprime, subjektit nuk i kishte lindur detyrimi për të deklaruar “dhurimin”.

6.48 Referuar përmbajtjes së deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.10.2015, ku shtetasi R.B ka deklaruar se “*Ka hequr dorë nga një apartament nr. **, kati **, me sipërfaqe 148.6 m² bruto dhe 136.6 m² sipërfaqe neto që e ka përzgjedhur sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.6.2014. Këtë apartament ia dhuron në mënyrë të barabartë familjarëve të vëllait të tij N.B (bashkëshortes së vëllait E.B , vajzës R.B dhe djalit J.B). Shoqëria “*** ” sh.p.k. vlerën korresponduese të këtij apartamenti ta konsiderojë të shlyer nga këta persona për këstet e pashlyera nga ata në dy kontratat e sipërmarrjes që shoqëria ka lidhur me ata, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.10.2015 dhe nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.10.2015” – është e qartë se secili nga pranuesit e dhurimit përfshirë edhe bashkëshorten e subjektit të rivlerësimit kanë përfituar me dhurim secili në mënyrë të barabartë nga 49.5 m² sipërfaqe apartamenti. Madje këtë sipërfaqe të përafërt, 50 m², subjekti e ka deklaruar edhe vetë pranë institucioneve financiare si burim i krijimit të apartamentit që bashkëshortja e tij dhe ai kanë porositur dhe paguar pjesërisht me kontratë sipërmarrjeje datë 24.10.2015.*

6.49 Sipas fakteve dhe rrethanave të evidentuara për këtë çështje, Komisioni vëren se dhurimi është një veprim juridik i kryer që në vitin 2015, ndërsa kontrata e sipërmarrjes ka qenë në fuqi edhe gjatë vitit 2016 dhe asnjë nga këto veprime juridike nuk është shfuqizuar apo revokuar, kështu që dhurimi i përfituar nga bashkëshortja e subjektit si bashkëporositëse e apartamentit së bashku me subjektin e rivlerësimit ka mbetur si burim i krijimit të një pjese të tij. Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë pasur detyrimin ligjor ta deklarojnë dhurimin si burim krijimi të një pjese të apartamentit, në vitin kur është kryer veprimi i dhurimit, pa e kushtëzuar detyrimin për deklarim me asnjë rrethanë tjetër.

6.50 Për sa më lart, Komisioni arriti në përfundimin se në deklaratën *Vetting*, subjekti ka bërë deklaram të pasaktë për pasurinë apartament me sip. 101 m², të porositur me kontratë sipërmarrjeje datë 24.10.2015, pasi nuk ka deklaruar “dhurimin” e sip. 50 m² nga xhaxhai i bashkëshortes së tij, si një nga burimet e krijimit të këtij apartamenti. Ky mosdeklarim i dhurimit për Komisionin nuk sjell pasoja për subjektin, për sa kohë nuk është bërë me qëllim fshehjen e saj, është provuar se përfitues të këtij dhurimi kanë qenë familja e bashkëshortes së subjektit dhe se kjo pasuri apartament është krijuar me burim të ligjshëm.

7. Depozitë bankare në BKT, dega Lushnjë, me nr. * llogarie, në shumën 2,750,000 lekë.** Të ardhura të siguruara nga ushtrimi i aktivitetit të profesionit të avokatit me nr. *** NUIS, jurist i jashtëm dhe biznesi familjar ndër vite (bashkëngjitur kontrata e depozitës datë 9.1.2017, lëshuar nga BKT-ja, dega Lushnjë).

7.1 Subjekti i rivlerësimit i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* një kontratë depozitë bankare datë 9.1.2017, e lidhur me BKT-në, me afat 6-mujor, në shumën 2,750,000 lekë.

7.2 BKT-ja konfirmon⁴⁷ se subjekti i rivlerësimit ka hapur depozitë me afat, e cila në datën 26.1.2017 ka balancën 2,750,000 lekë.

⁴⁷ Me shkresën nr. *** prot., datë 30.6.2017, nga BKT-ja.

7.3 DPPP-ja konfirmon⁴⁸ si transaksion bankar se në datën 6.1.2020 subjekti Gerti Shani ka derdhur në llogarinë e tij ***, në BKT, shumën 2,750,000 lekë.

7.4 Nga shqyrtimi i lëvizjeve të llogarive bankare të subjektit në BKT, Komisioni evidentoi se shuma 2,750,000 lekë është depozituar *cash* në datën 6.1.2017 kur subjekti ka tërhequr nga Credins Bank këto dy shuma: (i) shumën 2,005,950 lekë⁴⁹ që rrjedh nga maturimi i një depozite me afat 6-mujor, e çelur në datën 30.4.2016, në shumën 2 milionë lekë, me përshkrimin e veprimit bankar “Arkëton Gerti Shani kursime nga puna ndër vite”. Nga analiza financiare e subjektit para fillimit të detyrës, duket se ai dhe familja e tij kanë pasur një mundësi kursimi të mjaftueshme për depozitim e shumës 2 milionë lekë në prill të vitit 2016; (ii) shumën 575,004 lekë nga llogaria rrjedhëse, e cila në datën 11.10.2016 është kredituar me 660,000 lekë nga Ujësbellës Fshat Lushnjë me përshkrimin “Sa paguar paga të prapambetura”.

7.5 Diferenca është krijuar me pagat e përfituara gjatë periudhës brenda detyrës.

7.6 Pra, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e depozitës objekt shqyrtimi, në datën 6.1.2017, në BKT.

7.7 Për sa më lart, përputhet deklarimi i subjektit të rivlerësimit me dokumentacionin e administruar dhe Komisioni nuk konstatoi problematika në lidhje me këtë pasuri.

8. Llogari nr. * plus overdraft në BKT**, dega Lushnjë, për kartën e kreditit që i korrespondon kësaj llogarie (bashkëlidhur nxjerrja e llogarisë datë 3.1.2017). Overdraft në BKT, dega Lushnjë, nr. *** llogarie në shumën 100,000 lekë.

8.1 Subjekti i rivlerësimit i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* një përshkrim të llogarisë në BKT datë 3.1.2017, me gjendje 0.00 lekë.

8.2 BKT-ja konfirmon⁵⁰ se subjekti Gerti Shani ka llogari Credit Card me limit 100,000 lekë.

8.3 Në lidhje me këtë kartë që është përdorur nga janari 2013 e në vijim, u kërkua nga BKT-ja lëvizja e llogarisë së kartës dhe nga informacioni i përcjellë nga kjo bankë rezultoi se subjekti ka blerë mallra e shërbime të zakonshme⁵¹ që janë pjesë e shpenzimeve të jetesës në analizën financiare.

8.4 Nga përdorimi i kartës së kreditit bie në sy që subjekti ka kryer blerje të biletave të avionit shumë herë më tepër sesa ai dhe familja e tij kanë udhëtuar me avion jashtë vendit, sikurse provohet nga sistemi TIMS.

8.5 Për këtë situatë, subjekti ka shpjeguar⁵² se përveç biletave për udhëtime personale, ka blerë bileta avioni edhe për familjarë, të afërm e miq, meqenëse këta nuk kanë pasur kartë krediti dhe nuk e bënin dot vetë blerjen *online* në kompaninë e transportit ajror. Pasi i priste biletat e udhëtimit, secili prej tyre i ka dhënë *cash* vlerën e biletës dhe kjo shumë kalonte nga llogaria e kartës së kreditit të subjektit tek kompania ajrore përkatëse. Biletat e tjera që subjekti i rivlerësimit ka paguar

⁴⁸ Me shkresën nr. *** prot., datë 27.4.2017.

⁴⁹ Shuma e përftuar përbëhet nga kapitali prej 2 milionë lekësh dhe interesat e përftuar neto 5,950 lekë.

⁵⁰ Me shkresën nr. *** prot., datë 30.6.2017, të BKT-së.

⁵¹ Në analizë nuk janë përfshirë përdorimi i shumave nga karta e kreditit (e cila është hua) dhe as shlyerja e tyre, pasi ato balancojnë njëra - tjetrën dhe efekti financiar i tyre është 0.

⁵² Përgjigjja nr. *** e pyetësorit nr. ***.

dhe me të cilat ai ka udhëtuar, e provuar kjo edhe nga sistemi TIMS, janë shpenzime personale⁵³ të tij.

8.6 Nga sa më sipër, vlerësohet se deklaratimet e subjektit janë të vërteta pasi ato përputhen me verifikimin e udhëtimeve të tij në sistemin TIMS. Për rrjedhojë, shpenzimet për bileta të kryera për të tretë, nëpërmjet kartës së kreditit të subjektit, nuk janë përfshirë në analizën financiare si shpenzim i subjektit, pasi ato janë një shërbim apo ndihmë e dhënë prej tij ndaj personave të tretë, të cilët i kanë dhënë subjektit *cash* vlerën e biletës së blerë prej tij me kartën e kreditit.

8.7 Përputhet deklarimi i subjektit të rivlerësimit me dokumentacionin administruar.

9. Llogari në euro, nr. *, në BKT, dega Lushnjë** (bashkëlidhur nxjerrja e llogarisë datë 3.1.2017). Gjendja e llogarisë 0 (zero).

9.1 Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratën *Vetting* llogari datë 3.1.2017, me gjendje 0.00 euro⁵⁴.

9.2 BKT-ja konfirmon⁵⁵ se subjekti Gerti Shani ka llogari rrjedhëse në lekë dhe në euro, me gjendje 0 (zero).

9.3 Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar nga Komisioni.

10. Gjendje *cash* në shtëpi në shumën 1,500,000 lekë. Të ardhura të siguruara nga ushtrimi i aktivitetit, i profesionit të avokatit me nr. *** NUIS, juristit të jashtëm dhe biznesit familjar ndër vite.

10.1 Në lidhje me të ardhurat e siguruara nga ushtrimi i profesionit të avokatit me nr. *** NUIS, juristit të jashtëm dhe biznesit familjar ndër vite, dokumentacioni provues është pasqyruar në çështjen nr. 6 më lart⁵⁶.

Analiza financiare për krijimin e kësaj depozite

10.2 Meqenëse ky është deklarimi i vetëm i subjektit të rivlerësimit i bërë në deklaratën *Vetting*, për shkak të mosdetyrimit ligjor për deklarim periodik vjetor në ILDKPKI, ai është analizuar së bashku me familjen e tij, duke përdorur metodologjinë kumulative.

10.3 Sipas analizës së kryer, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për ta krijuar këtë shumë *cash* dhe shtesa të tjera likuiditetesh; për të krijuar pasuri dhe për të mbuluar shpenzimet gjatë periudhës së detyrës (shihni tabelën përmbledhëse nr. 7 në fund të këtij vendimi).

10.4 Për sa më lart, përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin administruar.

Deklarimi i pasurisë nga babai i subjektit të rivlerësimit, z. T.Sh

11. Pasuria shtëpi banimi me nr. *** pasurie, z. k. ***, me sip. 200 m² truall dhe ndërtesë me sip. 110 m², e ndodhur në lagjen “****”, Lushnjë, ndërtuar në vitin 1981 nga kursimet familjare

⁵³ Referuar pasaportës, nga ana e subjektit janë kryer udhëtime në datat 21.7.2013; 30.1.2014; 15.4.2014; 14.5.2014; 25.6.2014 dhe me biletën e blerë në datën 28.4.2016 ka udhëtuar në datën 11.5.2016.

⁵⁴ Aneksi nr. *** i dosjes *Vetting*.

⁵⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 30.6.2017 (Aneksi nr. *** i dosjes *Vetting*).

⁵⁶ Referim në Aneks nr. ***, nr. ***, nr. *** të dosjes *Vetting*.

(bashkëlidhur vërtetimi i pronësisë me nr. ***, datë 22.5.2001, lëshuar nga ZVRPP-ja Lushnjë në emër të shtetasit T.Sh). Pjesa takuese: 50%.

11.1 Kjo pasuri është deklaruar njësoj në deklaratën *Vetting* edhe nga nëna e subjektit të rivlerësimit, znj. Th.Sh .

11.2 Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* vërtetimin hipotekor nr. *** dhe hartën treguese datë 22.5.2001, nga ZVRPP-ja Lushnjë, ku pasuria nr. ***, z. k. ***, me sip. 200 m², në lagjen “****”, truall + ndërtesë (banesë 1 kat, sip. 110 m²) figuron i regjistruar në emër të shtetasit T.Sh .

11.3 ZVRPP Lushnjë konfirmon⁵⁷ se shtetasi T.J. Sh ka regjistruar pasurinë nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, në rrugën “****”, Lushnjë, lloji truall me sip. 200 m², nga të cilat ndërtesë me sip. 110 m² (banesë 1 kat).

11.4 ASHK Drejtoria Vendore Lushnjë konfirmon⁵⁸ se në emër të shtetasit T.Sh nuk figuron e regjistruar ndonjë pasuri, por në emër të subjektit Gerti Shani figuron e regjistruar pasuria nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, në rrugën “****”, Lushnjë, lloji truall me sip. 200 m², nga të cilat ndërtesë me sip. 110 m² (banesë 1 kat), si dhe kjo pasuri është rivlerësuar në datën 29.9.2012, me vlerën 5,216,860 lekë. Bashkëlidhur është dërguar; (i) i njëjti vërtetim pronësie datë 22.5.2001, që ka depozituar subjekti i rivlerësimit; (ii) vërtetimi nr. ***, datë 8.5.2000, nga Arkivi Shtetëror i Rrethit Lushnjë⁵⁹, që konfirmon se ky arkiv disponon vendimin nr. ***, datë 28.4.1979, të Këshillit Popullor të Qytetit, i cili ka vendosur që shtetasit T.Sh , banues në lagjen “****”, t’i japë leje ndërtimi për të meremetuar shtëpinë ekzistuese; (iii) vërtetimi nr. ***, datë 22.5.2001, të Rajonit nr. *** të Bashkisë Lushnjë që konfirmon se shtetasi T.Sh është banor i qytetit Lushnjë, lagjja “****”, përpara datës 1.1.1991; (iv) testamenti nr. ***, datë 13.11.2018⁶⁰, sipas të cilit shtetasi T.Sh ia lë trashëgim këtë pasuri djalit të tij Gerti Shani.

11.5 Nga hetimi rezultoi se kjo pasuri është krijuar në mënyrë të ligjshme nga babai T.Sh para se subjekti i rivlerësimit të emërohej në detyrë, por subjekti e ka fituar pronësinë mbi këtë pasuri në datën 21.8.2021 kur u çel dëshmia e trashëgimisë testamentare të babait të tij.

11.6 Për sa më lart, përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar nga Komisioni dhe nuk u konstatuan problematika në lidhje me këtë pasuri.

12. i) Pasuri tokë bujqësore në S, Lushnjë, me nr. *** pasurie, me sip. 8,014 m², si dhe pasurinë nr. ***, me sip. 5,576 m² tokë bujqësore, e ndodhur në S, Lushnjë, të marrë në përdorim me AMT në përdorim nr. *** akti, datë 6.7.1993, kaluar në pronësi me vendim të KKKP ish Pronarëve, Këshilli i Rrethit Lushnjë me nr. ***, datë 28.10.1999 (bashkëlidhur vendimi i Komisionit të Kthimit e Kompensimit të Pronave ish Pronarëve, Këshilli i Rrethit Lushnjë me nr. ***, datë 28.10.1999, si dhe AMT në përdorim nr. *** akti, datë 6.7.1993, në emër të shtetasit T.Sh).

⁵⁷ ZQRPP-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 5.10.2017, ka bashkëlidhur shkresën nr. *** prot., datë 27.9.2017, “Përgjigje” e ZVRPP-së Lushnjë.

⁵⁸ Me shkresën nr. *** prot., datë 23.6.2023, e ASHK Drejtoria Vendore Lushnjë, drejtuar Komisionit.

⁵⁹ Vërtetimi nr. ***, datë 8.5.2000, i Arkivit Shtetëror të Rrethit Lushnjë, bashkëlidhur shkresës nr. *** prot., datë 5.10.2017, të ZQRPP-së.

⁶⁰ Testamenti i çelur me dëshminë e trashëgimisë testamentare nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.8.2021, noter Sh.Sh.

ii) Pasuri e trashëguar nga babai i tij si ish-pronar J.Sh, njohur dhe kaluar në pronësi me vendimin e Komisionit të Kthimit e Kompensimit të Pronave ish Pronarëve, Këshilli i Rrethit Lushnjë, me nr. ***, datë 28.10.1999. Pjesa takuese: 100%.

12.1 Subjekti i rivlerësimit i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting*: (a) vendimin nr. ***, datë 28.10.1999, të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve (KKKPP) pranë Këshillit të Rrethit Lushnjë, me të cilin shtetasit T.Sh (si trashëgimtar i ish-pronarit J.Sh , babai i tij) i ka kaluar në pronësi toka bujqësore me sip. 13.590 m², që e kishte fituar edhe me AMT në përdorim në datën 6.7.1993, në S, Lushnjë; (b) AMT në përdorim nr. akti ***, datë 6.7.1993, të sip. 13.590 m², në emër të shtetasit T.Sh , në S, Lushnjë.

12.2 ZVRPP Lushnjë konfirmon⁶¹ se toka me sip. 13.590 m² është pasuri me AMT në përdorim dhe jo në pronësi, ndërsa ASHK Drejtoria Vendore Lushnjë konfirmon⁶² që nuk është regjistruar tokë bujqësore me sip. 13.590 m², në pronësi të shtetasit T.Sh apo të subjektit Gerti Shani.

12.3 Në lidhje me këtë situatë, subjekti ka shpjeguar gjatë hetimit⁶³ se vendimi nr. ***, datë 28.10.1999, i KKKP-së që e njohu z. T.Sh pronar të sip. 13.590 m², nuk është regjistruar në ZRPP deri në vitin 2017, sepse zona kadastrale ku ndodhet toka bujqësore nuk është futur në sistemin e ri të regjistrimit dhe nuk mund të kryhet asnjë procedurë për regjistrimin e saj në ASHK.

12.4 Për sa më lart, përputhet deklarimi i subjektit të rivlerësimit me dokumentacionin e administruar nga Komisioni dhe nuk u konstatuan problematika në lidhje me këtë pasuri.

13. Automjet tip “**”,** me targë AA ***, vit prodhimi 2011, me nr. *** shasie, pajisur me certifikatën e pronësisë nr. *** dhe nr. *** serie, datë 18.7.2016, në emër të shtetasit T.Sh , blerë nga kursime familjare në vite, vlera e blerjes 14,500 euro. Pjesa në zotërim: 100% (bashkëngjitur certifikata e pronësisë së mjetit, leja e qarkullimit nr. *** dhe nr. ***, në emër të shtetasit T.Sh , si dhe fatura e blerjes në Gjermani, datë 17.5.2016, në emër të shtetasit T.Sh).

13.1 Subjekti i rivlerësimit i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* dokumentacionin që provon origjinën e pronësisë së automjetit: (i) kontratë shitjeje datë 13.5.2016, sipas së cilës shtetasi T.Sh ka blerë nga M.S automjetin tip “****”, me nr. *** shasie, me vlerë 14,450 euro; (ii) fatura e blerjes së automjetit në Gjermani datë 13.5.2016, në emër të shtetasit T.Sh , me vlerë 14,450 euro; (iii) certifikatë pronësie datë 18.7.2016 e mjetit me targë AA ***, tip “****” të regjistruar në emër të shtetasit T.Sh ; (iv) leje qarkullimi datë 18.7.2016, e automjetit me targë AA ***, në emër të shtetasit T.Sh .

13.2 Në pyetësin standard⁶⁴, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se e ka përdorur këtë automjet që nga maji 2016 (kur është blerë në Gjermani) deri kur ka ndërruar jetë babai i tij në datën 7.6.2019. Gjithashtu, ka deklaruar⁶⁵ se në datën 11.5.2016 - 18.5.2016 ka udhëtuar në Gjermani me bashkëshorten për të blerë këtë automjet për babain e tij.

⁶¹ Me email datë 20.12.2017 të ZVRPP Lushnjë (dosja *Vetting*).

⁶² Shkresa nr. *** prot., datë 23.6.2023 e ASHK Drejtoria Vendore Lushnjë, drejtuar Komisionit.

⁶³ Përgjigjja nr. *** e pyetësorit nr. ***.

⁶⁴ Përgjigjja nr. *** e pyetësorit standard.

⁶⁵ Përgjigjja nr. *** e pyetësorit standard.

13.3 DPSHTRR-ja konfirmon⁶⁶ se shtetasi T.Sh ka të regjistruar mjetin me targë AA ***, por aktualisht figuron në emër të subjektit Gerti Shani. Referuar dokumentacionit bashkëlidhur (përveç dokumentacionit të njëjtë me ato që ka depozituar subjekti i rivlerësimit), rezulton se me testamentin nr. ***, datë 13.11.2018, shtetasi T.Sh ia ka lënë automjetin në trashëgim subjektit të rivlerësimit. Sipas aktit të zhdoganimit nr. ***, datë 15.7.2016, automjeti me vlerë 14,450 euro është zhdoganuar me eksportues A S *** Gjermani dhe importues T.Sh . Me autorizimin nr. ***, datë 15.7.2016, të degës së doganës Fier, shtetasi T.Sh përjashtohet nga pagimi i taksave doganore si invalid tetraplegjik. Sipas faturës së shitjes datë 17.5.2016, automjeti është blerë nga shtetasi T.Sh me çmimin 14,450 euro. Në deklaratën noteriale datë 2.6.2016⁶⁷, shtetasi T.Sh deklaroi se ky automjet, pasi të zhdoganohej do të përshtatet që ai të integrohet si invalid tetraplegjik në jetën e përditshme dhe djali i tij Gerti Shani do ta ndihmojë çdo herë që ai ka nevojë për të lëvizur me këtë automjet dhe do e përdorë në çdo rast që do të jetë e nevojshme brenda e jashtë Shqipërisë. Gjithashtu, deklaroi se prokura datë 14.5.2010⁶⁸, që ai i ka dhënë subjektit Gerti Shani për të kryer veprime para institucioneve në lidhje me këtë automjet, mbetet në fuqi. Sipas kësaj prokure, shtetasi T.Sh autorizon djemtë e tij A e Gerti Shani që të veprojnë në emër e për llogari të tij për të lidhur kontratën e blerjes së një automjeti për atë, në Shqipëri ose jashtë saj. Sipas policës së sigurimit datë 18.7.2016 figuron pronar T.Sh , përdorues Gerti e R.Sh.

13.4 Gjatë hetimit, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar⁶⁹ se automjeti me targë AA *** ka qenë në pronësi të babait T.Sh dhe pas vdekjes së tij, me lëshimin e dëshmisë testamentare pronësia ka kaluar në emrin e subjektit të rivlerësimit (Bashkëngjitur subjekti ka depozituar të njëjtin dokumentacion si në deklaratën Vetting dhe në dosjen e DPSHTRR-së, si dhe certifikatën e pronësisë nr. ***, datë 25.8.2021, të automjetit në emër të subjektit Gerti Shani).

13.5 Nga lëvizja e llogarisë së subjektit të rivlerësimit nr. *** në BKT, është evidentuar se në datën 25.8.2016 është transferuar shuma 2,720 euro, ku urdhërues është A.S *** Gjermani, me përshkrimin “Depozitë e kthyeshme për ***”. Në lidhje me këtë shumë, subjekti ka shpjeguar⁷⁰ se kjo shumë e cituar edhe në faturën e blerjes së automjetit në Gjermani nr. ***, datë 13.5.2016, përfaqëson kthimin e vlerës së TVSH-së që ai kishte parapaguar tek koncensionari A.S *** në momentin e blerjes së automjetit në Gjermani, ashtu si kishin rënë dakord që kjo vlerë do të kthehej sapo automjeti të dilte jashtë kufijve të Bashkimit Europian dhe të regjistrohej në Shqipëri.

Analiza financiare për mundësinë e krijimit të kësaj pasurie

13.6 Analiza financiare mbi mundësinë e subjektit për të blerë këtë automjet është kryer bazuar në metodologjinë kumulative.

13.7 Në pyetësin nr. ***, subjekti ka shpjeguar se nga llogaria e tij në Alpha Bank ka tërhequr shumën 17,000 UDS dhe një pjesë të saj e ka përdorur për blerjen e automjetit të babait në vitin 2016 (pjesën tjetër e ka ridedepozituar në bankë), sikurse trajtuar hollësisht në çështjen 4 më lart.

13.8 Nga kjo analizë rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të blerë këtë automjet, për të krijuar shtesa likuiditetesh dhe për të

⁶⁶ Me shkresën nr. *** prot., datë 6.6.2023, të DPSHTRR-së, dërguar pranë Komisionit.

⁶⁷ Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.6.2016.

⁶⁸ Prokurë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.5.2010, e T.Sh

⁶⁹ Përgjigjja nr. *** e pyetësorit nr. ***.

⁷⁰ Përgjigjja nr. *** e pyetësorit nr. ***.

mbuluar shpenzimet gjatë periudhës së detyrës, për shkak të një balance pozitive kumulative (shihni vitin 2016 në tabelën përmbledhëse nr. 7 në fund të këtij vendimi).

13.9 Për sa më lart, përputhet deklarimi i subjektit të rivlerësimit me dokumentacionin e administruar nga Komisioni dhe nuk u konstatuan problematika në lidhje me këtë pasuri.

14. Kontratë shitjeje nr. * rep., nr. *** kol., datë 19.4.2016**, për shitjen e automjetit në pronësi të shtetasit T.Sh , tip “***”, me targë AA ***. Vlera e shitjes: 100,000 lekë. Pjesa takuese: 100%.

14.1 Subjekti i rivlerësimit i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.4.2016, ku shtetasi T.Sh i shet blerësit J.B automjetin tip “***”, me targë AA ***, kundrejt çmimit 100,000 lekë, i likuiduar midis palëve jashtë zyrës noteriale.

14.2 DPSHTRR-ja konfirmon⁷¹ se shtetasi T.Sh ka pasur të regjistruar në emrin e tij automjetin me targë AA *** që sipas deklaratës së shitjes verbale datë 24.5.2010 e ka blerë me çmimin 4,000 euro nga D.A, Itali, i cili ka qenë pronar sipas certifikatës së pronësisë datë 24.5.2010.

14.3 Noteri Sh.Sh konfirmon⁷² lidhjen e kësaj kontrate përpara tij. Gjithashtu, automjeti është shitur me çmim më të lirë sesa çmimi i blerjes.

14.4 Blerja e këtij automjeti në shumën 4,000 euro ose 555,240 lekë⁷³ është përfshirë si pasuri në analizën financiare të subjektit në vitin 2010, pra para detyrës. Nga kjo analizë rezultoi se shtetasi T.Sh ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e automjetit. Për rrjedhojë, të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit janë të ardhura të ligjshme. Vlera e shitjes prej 100,000 lekësh, e cila është më e ulët se vlera e blerjes së automjetit, është përfshirë si e ardhur në analizën financiare të subjektit për vitin 2016.

14.5 Për sa më lart, përputhet deklarimi i subjektit të rivlerësimit me dokumentacionin e administruar nga Komisioni dhe nuk u konstatuan problematika në lidhje me këtë pasuri.

15. i) Detyrim monetar që ka Bashkia Lushnjë në zbatim të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. ***, datë 22.7.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë (bashkëngjitur vendimi nr. ***, datë 22.7.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë). Bashkia Lushnjë ka detyrim në shumën 673,137 lekë, dëm të shkaktuar dhe shpenzime gjyqësore në shumën 77,934 lekë.

ii) Detyrim monetar që ka shtetasja Sh.T në zbatim të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. ***, datë 22.7.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë (bashkëngjitur vendimi nr. ***, datë 22.7.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë). Shtetasja Sh.T ka detyrim në shumën 141.469 lekë dëm të shkaktuar dhe shpenzime gjyqësore në shumën 77.934 lekë.

iii) Llogari bankare nr. *, në NBG, dega Lushnjë**, ku janë kryer pagesa periodike nga Bashkia Lushnjë në zbatim të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. ***, datë 22.7.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë (bashkëngjitur ekstrakti i llogarisë bankare datë 4.1.2017, lëshuar nga NBG, dega Lushnjë). Vlera e llogarisë aktualisht është në shumën 300,000 lekë.

⁷¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 6.6.2023, të DPSHTRR-së, dërguar pranë Komisionit.

⁷² Me shkresën datë 12.10.2023 të noterit Sh.Sh, drejtuar Komisionit.

⁷³ Kursi i këmbimit 1 euro = 138.81 lekë, Banka e Shqipërisë datë 31.12.2010.

15.1 Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting*: (i) vendimin nr. ***, datë 22.7.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me paditës T.Sh , të paditur Bashkia Lushnjë, Sh. T , shoqëria “****” sh.p.k., ku është vendosur detyrimi i Bashkisë Lushnjë dhe Sh. T që t’i paguajnë paditësit T.Sh respektivisht shumat 673,137 lekë dhe 141,469 lekë si shpërblim dëmi shkaktuar banesës së tij; (ii) një statment account nga NBG-ja, datë 4.1.2017, ku rezulton se në llogarinë e T.Sh t gjatë periudhës 31.3.2016 – 20.12.2016 janë kredituar disa shuma me vlerë totale 430,000 lekë, me përshkrimin “Detyrime/shpenzime gjyqësore”.

15.2 NBG-ja, me shkresën nr. ***, datë 22.6.2017, konfirmon se shtetasi T. J.Sh ka hapur llogari depozite në lekë, gjendja e së cilës në datën 26.1.2017 ka qenë 300,000 lekë.

15.3 Për sa më lart, deklarimi i babait të subjektit të rivlerësimit, z. T.Sh , përputhet me dokumentacionin e depozituar prej tij në lidhje me detyrimet e të tretëve ndaj tij, si dhe me përgjigjen e ardhur nga NBG-ja. Nuk u konstatuan problematika.

KONSTATIME TË TJERA

16. Objekt informal. Nga dokumentacioni bashkëlidhur shkresës nr. *** prot., datë 23.6.2023, të ASHK Drejtoria Vendore Lushnjë, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka aplikuar për legalizim të ndërtimit pa leje, sipas kërkesës nr. ***, datë 14.10.2021. Bashkëlidhur shkresës është kërkesa për aplikim dhe mandatarëkëtimi datë 14.10.2021 për pagesën e taksës 3,000 lekë në favor të ZVRPP-së Lushnjë për aplikim vetëdeklarimi.

16.1 Në lidhje me këtë, subjekti ka shpjeguar⁷⁴ se objekti informal që ka deklaruar për legalizim në vitin 2021 është një garazh makine dhe depo që e përdor në banesën e tij që ndodhet në lagjen “****”, rruga: “****”, Lushnjë. Objekti i ndërtuar nga babai T.Sh ka filluar dhe përfunduar së ndërtuari në vitin 2015 me shpenzimet dhe kursimet e babait, me profile hekuri e panel *sandwic*, në vlerën rreth 650,000 lekë. ASHK Drejtoria Rajonale Lushnje, pas aplikimit për legalizim nuk ka ndjekur asnjë procedurë dhe objekti nuk rezulton i regjistruar në Kadastrën Lushnjë (bashkëngjitur: formulari i legalizimit nr. ***, datë 14.10.2021 dhe dy foto të objektit).

16.2 Në përgjigje⁷⁵, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se objekti informal i ndërtuar nga babai i tij në vitin 2015 ka një sipërfaqe rreth 30 m², por nuk disponon asnjë dokumentacion provues, preventiv, situacion punimesh në lidhje me këtë objekt, sepse babai i tij ka ndërruar jetë. Pra, deklarimi i subjektit për vlerën e këtij objekti të ndërtuar pa leje është në nivel deklarativ.

16.3 Për të verifikuar deklarimin e subjektit, në kushtet e mungesës së dokumenteve shkresore, Komisioni i është referuar dy elementeve dhe konkretisht legjislacionit dhe çmimit referencë.

16.4 Referuar Udhëzuesit për zbatimin e VKM-së nr. 173, datë 29.3.2016, “Për miratimin e kostos fiskale në ndërtim dhe për mënyrën e përcaktimit të çmimit të shitjes së banesave”, orientohet që kostoja e një garazhi të mbuluar është 70% e një apartamenti banimi. Meqë struktura e garazhit është me profile hekuri dhe panele *sandwic* ajo është konsideruar sa ½ e vlerës së referencës së ndërtimit të një apartamenti. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe Kolegji kur orienton se në përcaktimin e kostos së ndërtimit, përveç referimit në çmimet e EKB-së, duhet të mbahen parasysht edhe rrethana të tjera si: konstruksioni i ndërtimit dhe elementet që janë përdorur për ndërtimin, si

⁷⁴ Përgjigjja nr. *** e pyetësorit nr. ***.

⁷⁵ Përgjigjja nr. *** e pyetësorit nr. ***.

dhe orienton që kostoja e objektit “garazh” nuk mund të përlllogaritet me koston e plotë të ndërtimit⁷⁶.

16.5 Bazuar në udhëzimin nr. 4, datë 30.9.2015, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2015”, rezulton se kostoja e ndërtimit të banesave në qytetin e Lushnjës është 31.360 lek/m². Nëse konsiderojmë që kostoja e ndërtimit me kolona hekuri dhe panele *sandwic* është ½ e vlerës së referencës, atëherë kostoja e këtij objekti që përdoret për garazh do të ishte në vlerën 470,400 lekë⁷⁷.

16.6 Për sa më lart, vlera 650,000 lekë e deklaruar nga subjekti është përfshirë në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit për vitin 2015. Nuk u konstatuan problematika në lidhje me këtë pasuri.

17. Transfertë bankare. Nga lëvizja e llogarisë së subjektit në Intesa Sanpaolo Bank u evidentua se në datën 30.11.2010 ai ka kryer një depozitim në shumën 4,535 euro dhe në të njëjtën datë shuma 4,500 euro është transferuar jashtë Shqipërisë.

17.1 Pasi u pyet se për çfarë arsye është kryer kjo transfertë dhe tek cili person, subjekti ka shpjeguar⁷⁸ se shuma i është dërguar vëllait të tij në Itali për llogari të prindërve. Veprimi është bërë prej subjektit për shkak të gjendjes shëndetësore të babait të tij.

17.2 Shuma 4,500 euro është përfshirë si shpenzim në analizën financiare të subjektit dhe familjes së tij, për vitin 2010 (periudha përpara detyrës).

17.3 Për sa më lart, nuk u konstatuan problematika në lidhje me këtë veprim bankar.

18. Veprim bankar. Nga informacioni i përcjellë nga BKT-ja është evidentuar një veprim i kryer në arkë, si depozitim i shumës 48,000 lekë, në datën 4.2.2015, në llogarinë M.M, person fizik, me përshkrimin “Likuidim fature nr. ***, datë 30.1.2015, Z.P, derdhur nga Gerti Shani”.

18.1 Në lidhje me këtë veprim, subjekti ka shpjeguar⁷⁹ se pagesa është kryer për shkak të ushtrimit të profesionit të avokatit dhe përfaqësimit gjyqësor që ka bërë për këtë shtetas⁸⁰. Subjekti ka bashkëlidhur vendimin nr. ***, datë 23.2.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, ku pala paditëse Z.P është përfaqësuar nga av. Gerti Shani dhe av. M.M.

18.2 Nga verifikimi i dokumenteve të mësipërme del qartë që kjo pagesë e kryer nga subjekti është pagesë për shërbim avokatie të av. M për përfaqësimin gjyqësor të shtetasit Z.P . Pra, kjo shumë nuk është shpenzim i subjektit, prandaj nuk është përfshirë si shpenzim në analizën financiare.

⁷⁶ Në vendimin nr. 6, datë 17.3.2022, paragrafi 14.8, Kolegji ka mbajtur qëndrimin se nga çmimi i EKB-së duhet të zbriten elementet e fitimit të planifikuar dhe fondit rezervë, që janë në masën 10% të koston së ndërtimit. Përveç zbritjes së dy elementeve, duhet të mbahet parasysh edhe konstruksioni i ndërtimit dhe elementet që janë përdorur për ndërtimin shtesë. Jo në çdo rast kostoja e ndërtimit është ajo e përcaktuar nga EKB-ja, pasi ndryshon baza e përlllogaritjes, ajo e llojit të ndërtimit ndërmjet ndërtimeve të kryera nga EKB-ja dhe ndërtimit shtesë të kryer nga prindërit e bashkëshortes. Ndërsa në vendimin e tij nr. 34/2022, paragrafi 15.2, Kolegji sugjeron se: “...Në vijim, Komisioni duhet të kryejë një analizë të kuadrit ligjor rregullator të kostove të ndërtimit në kohën respektive. Nuk gjenden referenca për përcaktimin e kostove të ndërtimit për objektin “papafingo”. Sa rezulton, Komisioni duhet të vendosi të analizojë raste të objekteve që nuk përlllogariten me koston e plotë të ndërtimit, siç janë “karabinaja” apo “garazhi”, për të dalë në një vlerësim më të përafërt dhe të saktë, për përlllogaritjen e koston së ndërtimit të objektit papafingo”.

⁷⁷ Përlllogaritja e kryer është 31.630 lekë/m² x sip. 30 m².

⁷⁸ Përgjigjja nr. *** e pyetësorit nr. ***.

⁷⁹ Përgjigjja nr. *** e pyetësorit nr. ***.

⁸⁰ Ka parasysh shtetasin Z.P. Shihni përgjigjen e pyetjes nr. *** tek pyetësi nr. ***.

19. Arkëtime dhe transfertat. Gjatë hetimit administrativ, nga verifikimi i lëvizjeve të llogarive bankare pranë BKT-së dhe Credins Bank kanë rezultuar disa arkëtime dhe transfertat.

19.1 Për të verifikuar nëse këto veprime/transaksione janë likuiditete të subjektit apo shërbime kryer ndaj klientëve të tij gjatë ushtrimit të profesionit të avokatit, subjektit iu kërkua informacion i plotë dhe i koordinuar për: arsyet/burimin e këtyre transfertave/arkëtimeve; dokumentimin e tyre; dhënien e shumave tek palët ndërgjyqëse; dhe dokumentimin e dhënies së këtyre shumave.

19.2 Në përgjigje⁸¹, subjekti ka depozituar informacionin e kërkuar⁸², shpjegimet dhe dokumentet mbështetëse⁸³ në lidhje me veprimet bankare të kryera në tri banka si më poshtë:

19.2.1 Subjekti ka transferuar në llogarinë e shtetasit M.M , në BKT, shumën 800,000 lekë, në datën 24.7.2015. Nga krahasimi i lëvizjeve të llogarisë së subjektit në këtë bankë me deklaratimet e tij në përgjigje të pyetësorit nr. *** është evidentuar se subjekti i ka dhënë hua këtë shumë shtetasit M.M . Kjo hua i është kthyer subjektit në gusht 2015 sipas deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.12.2023. Si dokumentacion provues, bashkëlidhur përgjigjes së pyetësorit nr. *** , subjekti ka depozituar nxjerrje llogarie nga BKT-ja, printuar datë 21.12.2013, si dhe këtë deklaratë noteriale ku shtetasi M.M deklaron se në datën 24.7.2015 ka marrë hua nga kolegu i tij Gerti Shani shumën 800,000 lekë, me qëllim blerjen e një apartamenti, por meqë nuk ka rënë dakord me firmën ndërtuese, kjo shumë nuk i duhej më dhe ia ka kthyer subjektit në gusht 2015.

19.2.2 Meqenëse kjo shumë është dhënë dhe kthyer brenda periudhës 18.6.2015 – dhjetor 2015, kur subjekti ishte në detyrë, kjo hua nuk ka qenë detyrim të deklarohej si e tillë në deklaratën *Vetting* kur nuk ekzistonte më si detyrim.

19.2.3 Sa i takon mundësisë së subjektit për të dhënë këtë hua, rezultoi se ai ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për dhënien e saj, me kursime të periudhës para detyrës.

19.3 Transaksioni në vlerën 4,500,000 lekë, në BKT, për llogari të shtetasve T.Q, etj. Referuar të dhënave nga BKT-ja dhe të dhënave që subjekti ka plotësuar në tabelën bashkëlidhur pyetësorit nr. ****, rezulton se në datën 15.7.2015, personi fizik “G.Sh” ka arkëtuar nga S.U.G Austria shumën 4,500,000 lekë, me përshkrimin “Dëm TPL praktika ***/ shënd/2015”. Në datën 16.7.2015, personi fizik “G.Sh” ka kaluar shumën 3,200,000 lekë në llogarinë e shtetasit T.Q, me përshkrimin “Në zbatim të prokurës”. Në gusht 2015, subjekti i ka dhënë shumën 1,300,000 lekë shtetasve T.Q, Zh.Q , S.Q si shpërblim dëmi për qëllim të “Dëm TPL praktika ***/ shënd/2015”.

19.3.1 Bashkëlidhur pyetësorit nr. *** , subjekti depozitoi dokumentet që provojnë këto veprime⁸⁴.

⁸¹ Përgjigja nr. *** e pyetësorit nr. ***.

⁸² Informacion i pasqyruar në tabelën bashkëlidhur pyetësorit nr. **** të kërkuar nga Komisioni.

⁸³ Nxjerrje llogarie nga Credins Bank, printuar në datën 26.12.2023, depozituar nga subjekti në pyetësorin nr. ***.

⁸⁴ (i) Nxjerrje llogarie nga BKT-ja, printuar datë 21.12.2023; (ii) vendim nr. *** , datë 16.7.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me palë ndërgjyqëse T, S e Zh. Q dhe S.U.G.A , me objekt “Shpërblim dëmi pasuror e jopasuror për shkak aksidenti”; (iii) deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.1.2021, ku T. Q deklaron se ka caktuar subjektin si përfaqësues në gjyqin me objekt “Shpërblim dëmi nga aksidenti rrugor” dhe në përfundim të gjykimit ka përfituar nëpërmjet llogarisë së subjektit shumën 3,200,000 lekë, ndërsa diferencën 1,300,000 lekë e ka marrë *cash* prej tij në muajin gusht 2015, duke u shlyer kështu plotësisht detyrimi gjyqësor; (iv) prokurë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.12.2014 ,për përfaqësimin e shtetasit T.Q nga subjekti në gjyq dhe ekzekutimin e vendimit.

19.3.2 Për sa më lart, rezultoi se shuma 4,500,000 lekë, e kredituar në llogarinë e personit fizik “G.Sh” përpara fillimit të detyrës së subjektit, ka burim të ligjshëm, i përket familjarëve Q që ai ka përfaqësuar në gjykim dhe është përfituar plotësisht prej tyre.

19.4 Nga verifikimi i këtyre lëvizjeve bankare në BKT, subjekti ka provuar se shumat e transferuara nga palë të treta/persona juridikë janë kryer për shkak të ushtrimit të funksionit të tij si avokat. Në këto transaksione subjekti ka luajtur një rol ndërmjetës dhe shumat, që kanë hyrë në llogari të tij janë transferuar tek palët ndërgjyqëse të përfaqësuara nga subjekti dhe/ose janë tërhequr dhe dhënë *cash* tek këto palë.

19.5 Veprimi i fundit i kryer nga subjekti në këtë llogari në BKT është në datën 12.8.2015 kur ai ka tërhequr/transferuar të gjitha shumat e mbetura në llogari, për shkak të fillimit të detyrës.

19.6 Në periudhën 24.3.2015 – 20.11.2015, subjekti ka derdhur në llogarinë e tij në Credins Bank vlerën totale 2,130,200 lekë të ndarë në tri shuma (928,000 lekë në datën 24.3.2015; 402,200 lekë në datën 14.6.2015; 800,000 lekë në datën 20.11.2015) me përshkrimin “Arkëton Gerti Shani, të ardhura nga puna e kryer” dhe në tabelën bashkëlidhur pyetësorit nr. ***, subjekti ka cituar “Kursime familjare ndër vite nga puna si avokat”.

19.6.1 Këto shuma të arkëtuara nga subjekti me përshkrimin “Nga puna e kryer” janë konsideruar si pasuri personale e subjektit dhe janë përfshirë në analizën financiare të tij, si pjesë e likuiditeteve, në rastin që ato janë në llogari në fund të vitit/eve kalendarike. Sidoqoftë, nga analiza financiare e kryer, subjekti ka pasur mundësinë t’i krijojë këto depozita (shihni rezultatin financiar për periudhën para detyrës, trajtuar në çështjen 5.10).

19.6.2 Veprimi i depozitimit të shumës 800,000 lekë, në datën 20.11.2015, pas emërimit në detyrë të subjektit, meqenëse është pjesë e likuiditeteve në datën 31.12.2015, është i përfshirë në analizën financiare të këtij viti. Mundësia për krijimin e kësaj shume është pjesë e analizës financiare të datës 18.6.2015 deri më 31.12.2015, nga e cila ka rezultuar se subjekti dhe familja e tij kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për t’i krijuar këto depozita.

20. Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP), me shkresën nr. * prot., datë 27.4.2017, konfirmon transaksionet si në tabelën nr. 5**

Tabela nr. 5

Data	Banka	Nr. llogarie	Vleftha	Përshkrimi
19.9.2014	BKT	***	1.204.72 4 lekë	Gerti Shani tërheq nga llogaria, burimi i të ardhurave: “****” sh. a. për Gerti T.Sh, pagesë dëmi tpl.
15.10.2014	BKT	***	2.750.00 0 lekë	Gerti Shani tërheq nga llogaria. Burimi i të ardhurave: nga puna si avokat (ekzekutim vendimi gjykate).
19.6.2015	BKT	****	2.900.00 0 lekë	Gerti Shani derdh në llogari. Burimi i të ardhurave: tërhequr nga ISP.

20.1 Në lidhje me këto pagesa, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit: (i) të japë informacion të plotë dhe të koordinuar, duke plotësuar të dhënat e kërkuara në tabelën bashkëlidhur pyetësorit; (ii) për çdo arkëtim që ka marrë si përfaqësues i klientëve, të provojë dhënien e shumave tek

klientët e tij, me dokumentacion të shkruar ligjor (vendim gjyqësor i formës së prerë, prokurë për avokatin, marrëveshje midis palëve, urdhra ekzekutimi nga shoqëri përmbarimore, mandatpagesa që provojnë dhënien e shumës tek palët, deklaratat e palëve për marrjen e shumës *cash*, si dhe çdo dokument tjetër për të provuar deklaratimet e tij).

20.2 Në lidhje me shumën 1,204,724 lekë, me burim të ardhurash “nga *** sh. a. për Gerti T.Sh pagesë dëmi tpl”, që subjekti i rivlerësimit ka tërhequr në datën 19.9.2014 nga BKT-ja, në pyetëtorin nr. ***⁸⁵ ka shpjeguar se sipas vendimit nr. ***, datë 22.9.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë “Për pushimin e gjykimit” dhe sipas prokurës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.4.2014, ai ka qenë përfaqësues i shtetasve E e H.Xh dhe A.A në çështjen me objekt “Dëmshpërblim nga aksidenti” që është zgjidhur me pajtim dhe nga shoqëria “****” sh.a. është paguar nëpërmjet tij si avokat shuma 1,204,724 lekë, sipas pëlqimit të palës kreditore dhe palës debitore. Gjykata ka vendosur pushimin e gjykimit pas zgjidhjes me pajtim nga palët (bashkëlidhur, subjekti ka depozituar vendimin dhe prokurën si më lart).

20.3 Në pyetëtorin nr. ***⁸⁶, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar tabelën e kërkuar nga Komisioni me të dhëna në lidhje me pagesat e kryera. Bashkëlidhur përgjigjes, subjekti i rivlerësimit ka depozituar edhe nxjerrje llogarie nga Credins Bank, datë 26.12.2023, që provon se në datën 19.9.2014 subjekti ka arkëtuar në llogarinë e tij shumën 600,200 lekë si “*të ardhura nga puna*” dhe ka transferuar këtë shumë po në këtë datë, në llogari të përfituesve “*E.Xh ose H.Xh si pagesë në zbatim të prokurës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.4.2014*”. Ndërsa, aktmarrëveshjen e pajtimit midis palëve, subjekti shpjegon se nuk e disponon.

20.4 Referuar këtyre shpjegimeve të subjektit dhe të dhënave nga bankat e nga DPPP-ja, duket se nga shoqëria “****” sh.a., subjekti ka përfituar në llogarinë e tij në BKT, në datën 18.9.2014, shumën 1,229,724 lekë, me përshkrimin “Pagesë dëmi TPL Dosja *** dhe ****”, me qëllim dëmshpërblim nga aksidenti automobilistik datë 4.4.2008, në llogari të përfituesve E e H.Xh , A.A, sipas aktmarrëveshjes midis palëve dhe dosjes TPL, dosja *** dhe **** (që subjekti nuk i disponon). Nga kjo shumë, subjekti ka tërhequr në datën 19.9.2014 shumën 1,204,724 lekë e, njëkohësisht, ka depozituar në llogarinë e tij në Credins Bank shumën 600,200⁸⁷ lekë dhe e ka transferuar në llogari të përfituesve E.Xh ose H.Xh në bazë të prokurës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.4.2014.

20.5 Referuar vendimit gjyqësor nr. ***, datë 22.9.2014, rezulton se: (i) subjekti i rivlerësimit, si përfaqësues i palës paditëse, ka hequr dorë nga gjykimi i padisë, por nuk ka paraqitur asnjë shkak për këtë, ndryshe sa parashtron në përgjigjen e pyetëtorit nr. ***, ku shpjegon se çështjen e kanë zgjidhur me pajtim; (ii) në vendimin gjyqësor nuk citohet që palët e kanë zgjidhur çështjen me pajtim dhe as që kanë depozituar në gjykatë ndonjë aktmarrëveshje pajtimi të lidhur midis tyre; (iii) aksidenti automobilistik për të cilin pretendohet, dëmshpërblimi nuk ka ndodhur në datën 4.4.2008, sikur citon subjekti në tabelën që ka plotësuar bashkëlidhur pyetëtorit nr. ***, por ka ndodhur në datën 26.4.2009 (sikurse citohet në prokurën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.4.2014).

⁸⁵ Përgjigja *** e pyetëtorit nr. ***.

⁸⁶ Përgjigja nr. *** e pyetëtorit nr. ***.

⁸⁷ Megjithëse shuma 600,200 lekë është arkëtuar *cash* nga subjekti, ajo i përket “*Dëmshpërblim nga aksidenti automobilistik*” dhe është kaluar më transfertë bankare nga subjekti tek palët përfituesve, në bazë të prokurës që subjekti ka për përfaqësim. Depozitime të kësaj natyre janë të zakonshme për profesione të lira, në marrëdhëniet kontraktuale me klientët.

20.6 Pavarësisht nga këto rrethana, Komisioni mban parasysh që: subjekti ka pasur një prokurë nga shtetasit E.Xh , H.Xh dhe A.A për t'i përfaqësuar në proces gjyqësor me objekt “Shpërblim dëmi nga aksidenti automobilistik”; është zhvilluar një proces me palë ndërgjyqëse këta shtetas të përfaqësuar nga subjekti dhe me shoqërinë “****” sh. a.; subjekti ka përfituar në llogarinë e tij shumën 1,229,724 lekë nga kjo shoqëri që ka objekt veprimtarie “Sigurimin e pronës, jetës, etj.”; një ditë pasi ka arkëtuar shumën 1,229,724 lekë nga shoqëria “****” sh. a., subjekti i ka kaluar shtetasve që ka përfaqësuar në gjyq shumën 600,200 lekë, me qëllim shpërblim dëmi nga aksidenti automobilistik.

Këto fakte janë indicie që krijuan tek Komisioni bindjen se shuma 1,229,724 lekë, që ka përfituar subjekti dhe shuma 1,204,724 lekë, që ai ka tërhequr nga llogaria e tij, kanë të njëjtin burim të ligjshëm, si dhe nga 1,204,724 lekë, subjekti ka provuar që i ka kaluar palës që përfaqëson shumën 600,200 lekë.

20.7 Në lidhje me shumën 2,750,000 lekë me burim “nga puna si avokat (ekzekutim vendimi gjykate)” që në datën 15.10.2014 e ka pasur gjendje në llogarinë e tij në BKT, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar në pyetësonin nr. *** se ekzekutimi është bërë mbi vendimin nr. ***, datë 25.9.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë për çështjen me paditës M.G , M.S , V.B, E.K dhe G.G; të paditur shoqëria “****” sh. a. dhe shuma 2,750,500 lekë ka kaluar në llogari të kreditorëve në datën 15.10.2014, në Raiffeisen Bank, Lushnjë.

20.8 Bashkëlidhur përgjigjes, subjekti i rivlerësimit ka depozituar dokumentacionin provues⁸⁸, sipas të cilit pala kreditorë duhej të përfitonte 5.5 milionë lekë, por ka përfituar 2,750,000 lekë nëpërmjet llogarisë së subjektit të rivlerësimit.

20.9 Referuar të dhënave nga BKT-ja⁸⁹ dhe të dhënave që subjekti ka pasqyruar në tabelën e plotësuar në pyetësonin nr. *** (e përmbledhur për këtë çështje në tabelën nr. 6 më poshtë) rezulton se për efekt të ekzekutimit të vendimit gjyqësor për kreditorët G, deri në datën 15.10.2014 shoqëria debitorë “**** ” sh.a. ka kaluar disa pagesa në llogarinë e subjektit të rivlerësimit, të cilat janë në shumën totale 500,000 lekë, ndërsa shoqëria përmbarimore “B.S.A” sh.p.k. ka kaluar po në llogarinë e subjektit disa pagesa në shumën totale 3,647,900 lekë. Pra, deri në datën 15.10.2014, në llogarinë e subjektit është kredituar në total shuma 4,147,900 lekë, e cila e justifikon ekzistencën e shumës 2,750,000 lekë me burim “nga puna si avokat (ekzekutim vendimi gjykate)”, në llogarinë e subjektit në datën 15.10.2014.

⁸⁸ (i) vendimin nr. ***, datë 25.9.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, ku gjykata ka vendosur detyrimin e palës së paditur që t'i paguajë paditësit në total shumën 8,068,427 lekë; (ii) vendimin nr. ***, datë 16.10.2013, të Gjykatës së Apelit Vlorë, e cila ka vendosur ndryshimin e vendimit gjyqësor nr. ***, datë 25.9.2012 dhe zgjidhjen e çështjes me pajtim në bazë të marrëveshjes së palëve ndërgjyqëse, të cilat janë dakordësuar që shoqëria “****” sh. a. t'i paguajë paditësve në total shumën 5,500,000 lekë; (iii) vendimin nr. *** prot., datë 15.12.2014, të shoqërisë përmbarimore “****” sh.p.k. “Për pushimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor nr. ***, datë 25.9.2012” për shkak të ekzekutimit plotësisht të detyrimit nga shoqëria “****” sh. a.; (iv) 5 mandatet bankare datë 15.10.2014 të lëshuar nga Raiffeisen Bank Lushnjë, ku subjekti i rivlerësimit ka derdhur për të 5 përfituesit paditës (M.G, G.G , M.S , V.B, E.K) shumën totale 2,750,000 lekë; (v) deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.10.2009, ku subjekti deklaroi në emër të palës ndërgjyqëse që përfaqëson se detyrimi gjyqësor për aksidentin rrugor të datës 4.4.2008 është shlyer në mënyrë të kënaqshme dhe kreditorët nuk kanë më pretendime.

⁸⁹ Përgjigjja nr. ***, datë 3.5.2023, nga BKT-ja.

20.10 Në lidhje me vlerën që ka përfituar nga puna si avokat në këtë gjykim, subjekti ka shpjeguar⁹⁰ se ka përfituar vetëm shumën 40,000 lekë⁹¹. Nga shuma 5.5 milionë, shumat që i kalonin nga shoqëria debitore “***” sh. a. ia ka kaluar *cash* palës që përfaqësonte, ndërsa shumën përfundimtare 2,750,000 lekë ia ka kaluar në bankë.

20.11 Për sa më lart, rezultoi se shuma 2,750,000 lekë e ndodhur në llogarinë e subjektit të rivlerësimit në datën 15.10.2014 ka burim të ligjshëm “*nga puna si avokat (ekzekutim vendimi gjykate)*”.

Tabela nr. 6

⁹⁰ Përgjigjja nr. *** e pyetësorit nr. ***.

⁹¹ Të provuar me faturë tatimore nr. ***, datë 25.9.2012; librin e shitjes të printuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier dhe vendimin gjyqësor nr. ***, datë 25.9.2012, bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. ***.

Data e marrjes së shumës/ Banka	Shuma e marrë nga subjekti (lekë)	Përshkrimi i transaksionit	Qëllimi i dhënies së shumës	Personi përfitues i shumës	Data e dhënies së shumës/ Bankë ose cash	Shuma e dhënë (lekë)	Dokument provues
27.3.2014/ BKT	250,000	Transf. *** sh. a. për Gerti T.Sh , likuidim dëmi për kreditorët G, Dosja ***/2009	Dëmshpërblim nga aksidenti automobilistik datë 4.4.2008	M e G.G, M.S , V.B, E.K	27.3.2014/ BKT	250.000	Vendim nr. ***, datë 25.9.2012 i Gjyk.Rrethit Lushnjë dhe vendim nr. ***, datë 16.10.2013, i Gjyk.Apel Vlorë
27.3.2014/ BKT	130,000	“ “ “	“ “	“ “	27.3.2014/ BKT	130.000	“ “
28.3.2014/ BKT	120,000	“ “ “	“ “	“ “	28.3.2014/ BKT	120.000	“ “
2.6.2014/ BKT	1,100,000	Transfer B.S.A sh.p.k. për Gerti T.Sh , ekzekutim vendimi gjyqësor	“ “	“ “	2.6.2014/ BKT	1.100.000	Mandat bankar BKT njësuar nga *** datë 2.6.2014.
11.7.2014/ BKT	247,900	“ “ “	“ “	“ “	11.7.2014/ BKT	247.900	Nxjerrje llogarie
4.8.2014/ BKT	600,000	“ “ “	“ “	“ “	4.8.2014/ BKT	600.000	Mandat bankar BKT njësuar nga B.S.A datë 4.8.2014
11.8.2014/ BKT	400,000	“ “ “	“ “	“ “	11.8.2014/ BKT	400.000	Mandat bankar BKT njësuar nga B.S.A datë 11.8.2014
27.8.2014 BKT	800,000	“ “ “	“ “	“ “	27.8.2014 BKT	800.000	Mandat bankar BKT njësuar nga B.S.A datë 11.8.2014
2.10.2014 BKT	500.000	“ “ “	“ “	“ “	2.10.2014 BKT	500.000	Mandat bankar BKT njësuar nga B.S.A datë 2.10.2014
15.12.2014 BKT	251.124	“ “ “	“ “	“ “	15.12.2014 BKT	251.124	Mandat bankar BKT njësuar nga B.S.A datë 15.12.2014
15.12.2014 BKT	359,449	“ “ “	“ “	“ “	15.12.2014 BKT	359.444	Mandat bankar BKT njësuar nga B.S.A datë 15.12.2014. Vendim pushimi i ekzekutimit nr. *** prot., nr. regj. ***, datë 15.12.2014 B.S.A mandate postare (kopje të njehsuar)
13.9.2013/ Credins Bank	733,000	Urdhërues: C.D Likuidim nga “*** ” sh.a. për dëm me nr. ***/2009, kreditor M.G	Dëmshpërblim nga aksidenti automobilistik datë 4.4.2008/ Aktmarrëveshje midis palëve dosja TPL, dosje ***/2009.	“ “	13.9.2013 / Credins Bank	733.000	I përket të njëjtit rast sigurimi ku fillimisht ka pasur m. veshje pastaj ka vijuar me proces gjyqësor; deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.10.2009. Nuk e disponoj aktmarrëveshjen e plotë.
20.9.2013/ Credins Bank	294,000	“ “ “	“ “	“ “	20.9.2013/ Credins Bank	294.000	“ “

20.12 Në lidhje me shumën 2,900,000 lekë që ka derdhur në datën 19.6.2015 në llogarinë e tij në BKT, me burim “Tërhequr nga ISP”, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar⁹² se kjo shumë është transferuar nga NBG-ja në BKT, ku burim kanë qenë “Kursimet nga profesioni si avokat” dhe “Nga vendimi nr. ***, datë 22.7.2013 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë” që është ekzekutuar periodikisht me pagesa mujore të detyrimit nga debitorët Bashkia Lushnjë dhe Sh.T (bashkëlidhur, subjekti ka depozituar vendimin gjyqësor nr. ***, datë 22.7.2013⁹³). Referuar këtij vendimi, shtetasi T.Sh përfitonte në total shumën 814,606 lekë).

20.13 Nga dokumentacioni i NBG-së përcjellë pranë Komisionit evidentohet lëvizja e llogarisë së babait të subjektit në këtë bankë për periudhën mars – dhjetor 2016, balanca e së cilës ka qenë në këtë bankë deri në momentin e deklaratës *Vetting* e, për më tepër, shuma e akumuluar gjatë vitit 2016 nuk mund të ketë shërbyer për depozitim e shumës 2,900,000 lekë nga subjekti në datën 19.6.2015.

20.14 Meqenëse Komisioni nuk kishte administruar informacion nga BKT-ja për llogarinë e personit fizik “G.Sh” avokat, pra nuk mund të verifikohet përputhshmëria e veprimit bankar me informacionin e marrë nga DPPP-ja dhe deklaratimet e subjektit në pyetësin nr. ***, subjektit të rivlerësimit iu kërkua që të shpjegojë dhe depozitohet dokumentacionin ligjor në lidhje me: (i) veprimin e depozitimit *cash* të shumës 2.9 milionë lekë në BKT, në datën 19.6.2015; (ii) burimin e krijimit të shumës 2.9 milionë lekë; (iii) veprimin e tërheqjes nga NBG-ja⁹⁴, ku të evidentohet shuma e tërhequr; (iv) dokumentacionin e plotë për llogarinë e babait në NBG.

20.15 Në përgjigje të pyetësit nr. ***, subjekti ka deklaruar se:

- i) Në lidhje me depozitim *cash* të shumës 2.9 milionë lekë në BKT, në datën 19.6.2015, subjekti ka depozituar nxjerrje llogarie nga kjo bankë për llogarinë nr. *** të personit fizik “G.Sh”, ku evidentohet kryerja e këtij veprimi bankar me përshkrimin “Gerti Shani derdh në llogari”.
- ii) Në lidhje me burimin e krijimit të shumës 2.9 milionë lekë, subjekti ka shpjeguar se burim janë: (a) të ardhurat nga ushtrimi i profesionit të avokatit; (b) biznesi familjar; (c) kursimet familjare ndër vite, duke ndryshuar kështu deklarin e burimeve, dhënë në pyetësin nr.*** (pasi tashmë në pyetësin nr. *** shton si burime “biznesin familjar dhe kursimet familjare ndër vite”).
- iii) Në lidhje me veprimin e tërheqjes nga NBG-ja, ku të evidentohet shuma e tërhequr, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar⁹⁵ se *nuk disponon dokumentacion për tërheqjen e kësaj shume, pasi është kaluar cash nga të ardhurat nga puna dhe kursimet familjare, duke ndryshuar sërish deklarin e tij, dhënë në pyetësin nr. *** (ku deklaroi se kjo shumë është*

⁹² Përgjigja nr. *** e pyetësit nr. ***.

⁹³ Referuar vendimit gjyqësor nr. ***, datë 22.7.2013, të paditurit Bashkia L dhe Sh.T janë detyruar nga gjykata që t'i shpërblejnë paditësit T.Sh dëmin pasuror, respektivisht në shumat 673,137 lekë dhe 141,469 lekë. Ky vendim që është lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 19.11.2013, të Gjykatës së Apelit Vlorë.

⁹⁴ Shihni shpjegimet e subjektit në përgjigjen nr. ***, të pyetësit nr. ***, ku subjekti i rivlerësimit deklaroi se: “...*dua të sqarohet se është bërë transferimi i shumës nga NBG-ja në BKT, ku burim kanë qenë kursimet nga profesioni si avokat dhe vendimi gjyqësor nr. ***, datë 22.7.2013...*”.

⁹⁵ Përgjigja nr. *** e pyetësit nr. ***.

*transferuar nga NBG-ja në BKT, ku burim kanë qenë “kursimet nga profesioni si avokat” dhe “nga vendimi nr. ***, datë 22.7.2013, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë”).*

- iv) Në lidhje me lëvizjen e llogarisë së babait, si paditës dhe përfitues nga vendimi gjyqësor nr. ***, datë 22.7.2013, ku të evidentohen të gjitha depozitimet që nga fillimi i ekzekutimit të këtij vendimi, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar⁹⁶ se *vlerat monetare 751,071 lekë nga Bashkia L dhe 219,402 lekë nga Sh. T , të përfituara nga zbatimi i këtij vendimi, kanë shërbyer si të ardhura financiare përveç atyre të përfituara nga ushtrimi i profesionit të avokatit, biznesi familjar e kursimet familjare.* Pra, subjekti nuk ka dhënë informacionin e kërkuar në pyetësor.

20.16 Paralelisht, Komisioni kërkoi lëvizjen e llogarisë bankare pranë BKT-së për të evidentuar depozitim të shumës 2.9 milionë lekë. Nga lëvizjet e llogarisë së personit fizik “G.Sh”⁹⁷ rezultoi depozitimi i kësaj shume nga subjekti i rivlerësimit, si dhe tërheqja e saj me dy këste: 450,000 lekë në datën 22.6.2015 dhe 2,449,000 lekë në datën 26.6.2015.

20.17 Në konkluzion, shuma 2.9 milionë lekë që evidentohet e depozituar në BKT, sipas informacionit që Komisioni ka administruar nga DPPPP-ja, si dhe e verifikuar me lëvizjet bankare të subjektit në këtë bankë, është likuiditet/pasuri personale e tij dhe e ka burimin tek kursimet e subjektit dhe familjes së tij, të krijuara gjatë periudhës para fillimit të detyrës së subjektit.

20.18 Lidhur me mundësinë financiare për të depozituar këtë shumë, rezultoi se subjekti ka pasur mundësi ta depozitonte këtë shumë një ditë pas fillimit të detyrës, pasi ai dhe familja e tij kanë pasur mundësi për kursime në shumën 6,362,512 lekë në periudhën para fillimit të detyrës së subjektit⁹⁸.

20.19 Për të konkluduar në lidhje me veprimet bankare të evidentuara në llogaritë e subjektit para detyrës, duket se:

- i) transfertat hyrëse nga kompani sigurimi e zyra përmbarimore, përveç përshkrimit të veprimit bankar, evidentuar nga bankat, janë të mbështetura me dokumentacion justifikues;
- ii) është provuar dalja/pagesa e këtyre shumave me transfertat bankare ose *cash* tek individë, palë në procese gjyqësore, të përfaqësuara nga subjekti, rrethana këto që provojnë se transaksionet në fjalë nuk përbëjnë pasuri vetjake të subjektit të rivlerësimit, por veprime që janë kryer për/dhe gjatë ushtrimit të profesionit të avokatit prej tij;
- iii) depozitimet *cash* të kryera nga subjekti me përshkrimin “Depoziton Gerti Shani nga puna e kryer”, janë konsideruar në analizën financiare të subjektit si pasuri vetjake e tij dhe janë pasqyruar në rubrikën e likuiditeteve, në rastin kur janë gjendje në bankë në fund të çdo viti kalendarik.

21. Në lidhje me shpenzimet e subjektit për transportin nga banesa në adresën e punës

21.1 Nga fillimi i detyrës, subjekti është emëruar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, ndërsa banon në Lushnjë. Për këtë, Komisioni i kërkoi që të deklarojë shpenzimet e transportit nga banesa në punë dhe anasjelltas. Në përgjigje të pyetësorit nr. ***, subjekti ka sqaruar se ka udhëtuar herë me mjete të transportit publik, herë me automjetin e tij, herë me

⁹⁶ Përgjigja nr. *** e pyetësorit nr. ***.

⁹⁷ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 16.1.2024, nga BKT-ja, e administruar në dosjen e Komisionit.

⁹⁸ Shihni analizën financiare trajtuar në çështjen 5.9.

automjetin e kolegëve; ka udhëtuar rreth 20 ditë/muaj dhe shpenzimet e tij kanë qenë rreth 10,000 lekë/muaj.

21.2 Komisioni, duke përdorur si tregues deklaratimet e subjektit, ka kryer përlllogaritjet duke konsideruar: 22 ditë pune; udhëtimin si të kryer ½ e ditëve me mjete të transportit publik, ku bileta ka kushtuar 500 lekë vajtje-ardhje; gjysma tjetër me automjetin personal dhe/ose me automjetin e kolegëve, ku kostoja është përlllogaritur mesatarisht 1,000 lekë/udhëtim⁹⁹.

21.3 Në bazë të këtyre përlllogaritjeve, shpenzimet e transportit nga banesa në shtëpi dhe anasjelltas janë përfshirë në analizën financiare të subjektit për periudhën 18.5.2015 – 27.1.2017 kur është plotësuar deklarata *Vetting*.

Analiza financiare gjatë periudhës së rivlerësimit të subjektit

Tabela nr. 7

Përshkrimi (në lekë)	18.6 – 31.12.2015	2016	27.1.2017
Pasuri	609,219	3,691,250	1,708,176
Apartament me . 101 m ² , Lushnjë, blerë më 24.10.2015	910,000	686,000	
Automjet tip “****”, blerë më 13.5.2016 për babain		1,954,652	
<i>Shtesa /pakësime likuiditeteve</i>	<i>-300,781</i>	<i>1,050,598</i>	<i>1,708,176</i>
Gjendja e likuiditeteve	3,122,304	4,172,903	5,881,079
Të ardhura të dokumentuara	7,293,221	2,595,923	172,420
Të ardhura të subjektit nga paga si ndihmës gjyqtar	345,842	750,749	63,511
Të ardhura të bashkëshortes nga paga	169,836	464,208	38,684
Të ardhura të babait nga pensioni i invaliditetit nga viti 1991	89,377	187,800	15,650
Ndihmë nga Bashkia për të sëmurët nga 10/2008	238,740	477,480	39,790
Të ardhura të nënës nga pensioni nga 02/2010	86,914	177,420	14,785
Ekzekutimi i vendimit gjyqësor me Bashkinë Lushnjë - babai		430,000	
Të ardhura nga interesa bankarë		8,266	
Nga shitja e makinës “****”, më 19.4.2016		100,000	
Të mbartura nga periudha të kaluara	6,362,512		
Shpenzime	1,301,440	1,857,310	111,689
Shpenzime jetese për 5 persona	560,690	1,175,460	99,189
Shpenzime udhëtimi TIMS		500,350	
Shpenzime udhëtimi nga banesa në punë	90,750	181,500	12,500
Shpenzime për investime në banesë	650,000		
Mundësia për kursime	5,382,562	-2,952,638	-1,647,445
Mundësia për kursime kumulative	5,382,562	2,429,924	782,479

⁹⁹ Përlllogaritjet janë bazuar duke konsideruar që ½ e udhëtimeve është kryer me automjete personale, të subjektit dhe/ose kolegëve të tij, e ndarë kjo në mënyrë të barabartë; distanca Lushnjë-Vlorë 70 km, shpenzimi i karburantit të një makine mesatare 7 litra për 100 km; çmimi mesatar i karburantit për vitet 2015 – 2016 ka qenë 1.18 euro. Metodologjia e përlllogaritjes është bazuar në vendimin nr. 11 (JR), datë 22.5.2019, të Kolegjit. Nga përlllogaritjet e mësipërme ka rezultuar se shpenzimi në rastin e përdorimit të automjeteve personale është 1,000 lekë/ditë.

Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit

21.4 Komisioni, në vlerësimin e çështjes në lidhje me kriterin e pasurisë, bazuar në prova dhe bindjen e brendshme, çmoi se subjekti i rivlerësimit Gerti Shani ka bërë deklaram të mjaftueshëm për pasuritë e krijuara dhe justifikon me burime të ligjshme krijimin e tyre, duke zbritur edhe shpenzimet e jetesës, sipas përcaktimeve të shkronjës “a” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016; nuk ka kryer fshehje e pasurisë; nuk ka kryer deklaram të rremë; si dhe nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit. Deklarimi i pasaktë i një pasurie të vetme nuk e ngarkon subjektin me përgjegjësi deri në masën e shkarkimit e tij.

B. KONTROLLI I FIGURËS

22. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) ka dërguar pranë Komisionit raportin nr. **** prot., datë 27.10.2017, mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Gerti Shani, i padeklasifikuar. Sipas këtij raporti, Grupi i Punës së AKSIK-së informon se formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë e në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016.

23. Në përfundim të verifikimit, Grupi i Punës të AKSIK-së ka konkluduar se:

a) Subjekti i rivlerësimit ka pasur të njëjtat gjeneralitete si ato që ka deklaruar vetë në deklaramtën për kontrollin e figurës;

b) Për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimin të organizuar.

24. Sa më sipër, Grupi i Punës konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Gerti Shani.

25. Për sa më lart, Komisioni nuk ngriti dyshime për sa i përket përshtatshmërisë së subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e detyrës në lidhje me kriterin e figurës.

Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës

26. Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni për subjektin e rivlerësimit Gerti Shani nuk u gjetën elemente, që vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme të tij me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016, duke përfshirë edhe lëvizjet e subjektit për hyrje-daljet jashtë vendit sipas informacionit nga sistemi TIMS. Deklaramet e subjektit kanë rezultuar të sakta dhe të vërteta.

Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit Gerti Shani ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

27. Sipas informacionit të ardhur nga Komisioni i Përkohshëm për Vlerësimin Etik e Profesional pranë KLGJ-së¹⁰⁰, rezulton se Shkolla e Magjistraturës me vendimin nr. ***, datë 22.9.2020, ka bërë vlerësimin përfundimtar të këshilltarëve ligjorë për vitin akademik 2019 – 2020, midis të cilëve subjekti i rivlerësimit është vlerësuar “mirë” me 81.48 pikë. Me vendimin nr. ***, datë 12.11.2020, të KLGJ-së, subjekti i rivlerësimit Gerti Shani është emëruar këshilltar ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë.

28. Gjithashtu, KLGJ-ja informon Komisionin se subjekti i rivlerësimit ka kryer funksionin e ndihmësit ligjor në ish Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë pranë gjyqtarëve G.Xh dhe A.Sh, duke asistuar këta gjyqtarë në draftimin e vendimeve dhe në hartimin e vendimeve për disponim ankimi apo rekursi, por pranë kësaj gjykate nuk janë gjetur relacione apo mendime ligjore të subjektit të rivlerësimit gjatë periudhës së kërkuar.

29. Nga hetimi rezultoi se pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nuk janë depozituar denoncime për subjektin e rivlerësimit Gerti Shani.

Vlerësimi i Komisionit për aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit

30. Për sa më lart, në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit Gerti Shani, Komisioni, duke mbajtur parasysh vlerësimin nga Shkolla e Magjistraturës, si dhe karrierën në ngritje të subjektit, i cili nga ndihmës ligjor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë është emëruar këshilltar ligjor pranë Gjykatës së Lartë, arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, në kuptim të shkronjës “c” të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Gerti Shani ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas parashikimit të shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, referuar shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 58, si dhe pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

¹⁰⁰ Me shkresën nr. *** prot., datë 13.10.2023, të KLGJ-së, dërguar Komisionit.

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Gerti Shani, ndihmës ligjor pranë ish-Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, aktualisht me detyrë këshilltar ligjor pranë Gjykatës së Lartë.
 2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
 3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
 4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
- Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 20.3.2024.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Xhensila PINE
Kryesuese

Roland ILIA
Relator

Genta TAFA (BUNGO)
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Amela Idrizi